



**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE**  
PUNIM DISKUTUES

**“CENTRALIZIMI ETNIK DHE RREZIQET E ZGJIDHJEVE  
TË NDËRLIKUARA”**

Prishtinë, janar 2007

Ky projekt është përkrahur nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar – DFID.

Përgatitur nga: Ilir Dugolli, Bekim Çollaku dhe Ilire Agimi

Redaktuar nga: Leon Malazogu dhe Lulzim Peci

Copyright © 2007 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Pjesë të shkurtra të tekstit, që nuk kalojnë dy paragrafë, mund të citohen pa lejen shprehimore të dhënë nga autori me kusht që të njihet burimi i plotë i tekstit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 555 887.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39

Prishtinë, Kosovë (UNMIK)

Telefon dhe faks: +381 38 555 887

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shtatë vite pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, është në zhvillim e sipër procesi që synon gjetjen e zgjidhjes për statusin e ardhshëm të vendit. Si pjesë e pakos së statusit të ardhshëm një peshë të madhe e ka çështja e decentralizimit. Edhe pse për këtë ndërmarrje janë shpenzuar energji të konsiderueshme, qëndrimet e shqiptarëve dhe të serbëve karshi decentralizimit nxiten nga perceptime, frikë dhe interesa të ndryshme. Mbetet e paqartë nëse dhe në çfarë mase këto qëndrime do të ndryshojnë pas zgjidhjes së statusit, atëherë kur decentralizimi do të duhet të shndërrohet nga projekti në realitet.

Janë disa burime të konflikteve në të cilat ky punim diskutues<sup>1</sup> tërheqë vëmendjen.

### *Mospërgatitja si burim i konfliktit*

Ky punim diskutues tërheqë vëmendjen e qeverisë, komunave, partive politike, administratës ndërkombëtare dhe hisedarëve të tjerë relevantë në disa nga burimet shumë të mundshme të konfliktit, e që ndërlidhen me decentralizimin. Punimi si i tillë identifikon mundësinë e konflikteve të caktuara dhe nuk ka për qëllim të sugjeroj masat në kontekst të konflikteve të tilla. Megjithatë, është jashtë çdo dyshimi se të gjitha palët e përfshira në procesin e decentralizimit duhet të jenë të përgatitura për t'u përgjigjur në mënyrë të duhur e të bashkërenduar, nëse dëshirojnë të shmangin ose zbusin konfliktet e mundshme. Rrjedhimisht, kërcënimi më serioz në lidhje me decentralizimin do të vije në shprehje në rast se: (a) qeveria dhe administrata ndërkombëtare nuk përfillin kërcënime të cilat parashihen; (b) në rast se dështojnë të përgatiten në dritën e kërcënimeve të reja, apo (c) nëse përfundojmë në fajësime reciproke ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare, pushtetit dhe opozitës e kështu me radhë.

### *Reagimi i serbëve në veri të Kosovës*

Pasi që statusi i ardhshëm i Kosovës të jetë qartësuar ka të ngjarë që serbët në veri të Kosovës të përgjigjen me mosbashkëpunim, e ndoshta edhe me ndonjë formë të shpalljes së pavarësisë së zonave që momentalisht i kanë nën kontroll. Përderisa përkushtimi i kosovarëve për decentralizimin është i kushtëzuar me fitimin e pavarësisë brenda kufijve aktual, veprimi i tillë i serbëve do të sfidonte këtë përkushtim, jo vetëm për veriun e Kosovës, por edhe për pjesën tjetër të vendit. Negociatorët kosovarë janë pajtuar me aspektet e decentralizimit, disa prej të cilave me pasoja të hidhura, vetëm si një çmim për pavarësinë. Si rrjedhojë, me veriun e Kosovës të çimentuar në një territor jashtë pushtetit të Prishtinës, decentralizimi në mbarë territorin e Kosovës ka gjasa të dalë jashtë binarëve.

---

<sup>1</sup> Ku punim mbështetet në një varg dokumentesh që kanë qarkulluar ndërmjet UNOSEK-ut dhe palëve negociuese, sikurse edhe në pikëpamjet e palëve kryesore të përfshira në proces. Si pikë referuese për analizë, punimi përdorë dokumentin e fundit që UNOSEK-u u ka paraqitur të dy palëve në Prishtinë dhe Beograd (12 shtator 2006) dhe përqendrohet në fushat kryesore të përgjegjësisë që përmban dokumenti. Përveç kësaj, një numër i vendim-marrësve janë intervistuar në mënyrë që të merren sa ma shumë informacione që është e mundur nga perceptime dhe pritje të ndryshme në lidhje me zgjidhjet që ka të ngjarë që t'i përfshijë pakoja e decentralizimit.

### *Përkushtimi i kushtëzuar*

Përkushtimi i kushtëzuar i institucioneve të Kosovës do të vihet në pikëpyetje nëse statusit të ardhshëm do t'i mungojë qartësia e duhur. Nëse statusi mbetet i paqartë edhe për një kohë, në mënyrë që të mos shqetësoj ndonjërin nga palët dhe me shpresë për t'i mbajtur ato të përfshira në proces (veriun e Kosovës, institucionet e Kosovës, etj.) atëherë një gjë e tillë do rrisë kritikën kundër decentralizimit. Institucionet e Kosovës ose do të zmbarsen nga përkushtimi i tyre ndaj decentralizimit ose me ngurrim të madh do t'i përmbushin detyrimet e tyre që kanë të bëjnë me decentralizimin.

### *Ndarja e Mitrovicës*

Një tjetër kërcënim është ndarja e qytetit të Mitrovicës. Nëse gjendja ekzistuese e ndarjes *de facto* përforcohet edhe më shumë, kjo do të shërbente si burim i përhershëm i jo-stabilitetit për mbarë Kosovën. Zgjatja e ndarjes aktuale nënkupton vazhdimin e veprimit të strukturave të Serbisë, një sfidë kjo e drejtpërdrejt e autoriteteve qendrore dhe nxitje për ndarje etnike të thellë.

Palët e shohin në mënyra të ndryshme rolin e Bordit të qytetit, që pritet të themelohet në të ardhmen. Përderisa shqiptarët do të synojnë që këtë Bord ta përdorin si trampolinë drejt integritetit të pjesës veriore të Mitrovicës, serbët dëshirojnë që ky Bord të jetë i kufizuar në veprimtari këshillëdhënëse, madje me tundime mase të pranishme për ta bllokuar apo për ta bojkotuar fare këtë organ. Sido që të jetë, përfshirja dhe roli i Zyrës civile ndërkombëtare (ICO) do të jetë vendimtar për sa i përket Mitrovicës.

### *Shpallja e njëanshme e autonomisë politiko-territoriale*

Burim serioz i tensioneve do të ishte shndërrimi i komunave me shumicë serbe në një autonomi politike dhe territoriale. Gjatë negociatave dhe përmes një numri të komenteve në dokumentin e Ahtisarit delegacioni i Serbisë vazhdimisht i është referuar autonomisë. Në kontekst të së drejtës së komunave me shumicë serbe për të pasur bashkëpunim reciprok dhe për të krijuar asociacione, kërcënimi më serioz është nëse këto asociacione në mënyrë të njëanshme shpallin ndonjë formë të autonomisë territoriale.

### *Perceptimet kundërshtuese*

Ekzistojnë kërcënime të konsiderueshme që kanë të bëjnë me perceptimin e decentralizimit si të tillë. Edhe shqiptarët edhe serbët Kosovës e shikojnë decentralizimin përmes thjerrëzave të ndryshme dhe presin rezultate të ndryshme nga ky proces. Përderisa shqiptarët e shohin këtë proces si çmim për pavarësinë, serbët e shohin atë si mjet që do t'u garantojë atyre sa më shumë autonomi që do të jetë e mundur, jashtë ndikimit të institucioneve qendrore të Kosovës.

### *Mosnjohja e kufijve të komunave të reja*

Një burim potencial i kërcënimit ka të bëjë me kufijtë e komunave të reja që do të dalin si rezultat i decentralizimit. Në disa raste liderët e komunave që do të "humbin" pjesë të territorit të tyre në komunat e reja, kanë thënë troç se nuk do t'i njohin kufijtë e rij. Në terma praktikë një gjë e tillë do të nënkuptojë përpjekje të udhëheqësve të atyre komunave për të ushtruar pushtetin mbi pjesë të territorit që juridikisht nuk do të jetë më brenda fushëveprimit të tyre.

### *Mungesa e fondeve*

Ndarja e paqartë ndërmjet përgjegjësive të detyrueshme dhe atyre diskrecionale, përgjegjësive ekskluzive dhe të përbashkëta mund të vije në shprehje kur komunat e reja të mos jenë në gjendje të ushtrojnë përgjegjësitë që dëshirojnë. Rrjedhimisht, është thelbësore që donatorët të kenë gatishmëri për të ndihmuar financiarisht gjatë tri-katër viteve të tranzicionit të vështirë drejt shtetit funksional. Gjithashtu, është vendimtare që institucionet kosovare të vendosin kanale të duhura të komunikimit me të gjitha komunitetet dhe komunat në mënyrë që vështirësitë të identifikohen me kohë.

#### *Emërimet diskutabile*

Kur është fjala për përgjegjësitë e reja që do të kalohen të komunat me shumicë serbe, parashihen tensione lidhur me emërimet e drejtuesve të policisë. Mundësia më serioze e mundshme do të jetë mosnjohja e vijave të komandës brenda shërbimit policor. Si një burim i izoluar i tensionit ky skenarë ka relativisht pak gjasa që të shfaqet. Sidoqoftë, në rast të ndarjes së pjesës së veriut apo/dhe deklarimit të autonomisë territoriale një gjë e tillë do të vijë në shprehje vetvetiu.

#### *Mosnjohja e vendimeve të gjykatave të larta*

Sa i përket gjyqësisë kërcënimi më serioz mund të shfaqet në rastet kur gjykatësit në komunat me shumicë serbe nuk i marrin parasysh vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese, në rastet kur organet gjyqësore qendrore i anulojnë vendimet e gjykatave më të ulëta. Si një rast i izoluar ky skenar ka pak gjasa që të ndodh, por në rast të ndarjes së pjesës veriore të Kosovës, shpalljes së autonomisë territoriale, apo mos mosbindjes së zinxhirit komandues në fushën e policisë, një gjë e tillë do të vije në shprehje automatikisht.

#### *Financimi nga Beogradi*

Financimi nga Beogradi nuk shihet si problem serioz në aspektin afatshkurtër. Sidoqoftë, nga një vështrim në aspektin afatgjatë, financimi i pakontrolluar nga Beogradi do të paraqesë barrierë serioze për serbët e Kosovës që të zhvillojnë lojalitetin e tyre ndaj institucioneve të Kosovës. Kështu, sfida në këtë fushë shfaqet në formë të lejimit të së drejtës për donacione nga Beogradi, duke penguar në të njëjtën kohë që kjo të shndërrohet në barrierë kundër pranimit të pushtetit të institucioneve qendrore nga ana e Kosovës nga serbët e Kosovës.

#### *Arsimi*

Çështja e arsimit paraqet kërcënim nëse kontrolli mbi arsimin në komunat me shumicë serbe nuk kalohet nga Beogradi në institucionet e Kosovës. Çështjet praktike, siç është emërimi e dekanit të Universitetit në veri të Mitrovicës kanë gjasa që të shkaktojnë tensione ndërmjet institucioneve qendrore të Kosovës dhe komunitetit serb në Kosovë. Ky burim i konfliktit mund të ketë peshën e vetë serioze vetëm në rast se nuk ndahet Mitrovica dhe nëse komunat me shumicë serbe nuk deklarojnë autonomi politiko-territoriale.

Pasi që këto komuna të reja do të nisin të funksionojnë qëndrueshmëria e tyre do të vihet në pyetje. Rrjedhimisht, pasi që të zbehet rreziku që serbët tani e perceptojnë, do vijnë në shprehje realitetet e hidhura ku do të mund të ketë serbë që kërkojnë të ri-integrohen në komuna më të mëdha. Në të ardhmen, shumë më tepër shërbime të komunave do të mbështeten në të ardhura vetanake, dhe shumica nga komunat që nuk kanë burime përmbajtësore të të ardhurave do të jenë të hendikepuara në ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

## 2. Historiku

Me 24 tetor 2005, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara autorizoj fillimin e bisedimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës. Përfaqësuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari është ngarkuar me detyrën e udhëheqjes së bisedimeve dhe përgatitjes së pakos së rekomandimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës. Pakoja do t'i paraqitet Grupit të Kontaktit<sup>2</sup> në fillim të këtij viti. Pas marrjes së komenteve nga Grupi i Kontaktit, si dhe nga Prishtina e Beogradi, pakoja zgjidhëse pritet të dërgohet në Këshill të Sigurimit si një draft zgjidhje, ndonëse kjo mbetet e pasigurt.

Çështja e decentralizimit ka mbizotëruar bisedimet për statusin e ardhshëm të mbajtura në Vjenë. Decentralizimi konsiderohet si një ndër çështjet kritike për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës. Përmes këtij procesi, bashkësia ndërkombëtare përpiqet të siguroj mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të bashkësisë serbe dhe fuqizimin e tyre në komunat ku serbët përbëjnë shumicë.

Një numër i madh i kosovarëve e shohin decentralizimin si kundërthënës dhe të mbështetur në motive etnike. Siç del në pah nga një studim i mëhershëm 50-65% të shqiptarëve të Kosovës konsiderojnë si “të papranueshme”: (a) shtimin e përgjegjësisë të komunave serbe më shumë se të pjesëve të tjera, dhe (b) lejimin e këtyre komunave që të pranojnë ndihmë financiare apo ndihmë tjetër drejtpërsëdrejti nga Serbia.<sup>3</sup> I njëjti studim ka zbuluar se propozimet e decentralizimit janë më pak polarizuese brenda anëtarëve të së njëjtës bashkësi sesa statusi i ardhshëm dhe se ekziston një fleksibilitet i konsiderueshëm karshi decentralizimit, nëse kjo e fundit është pjesë e një pakaje më të madhe e të pranueshme.

### **Decentralizimi konsiderohet si një ndër çështjet kritike për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës.**

Elementet e para të animit kah decentralizimi në Kosovë hasen qysh në vitin 2001, kur ish Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), z. Hans Haekkerup dhe z. Nebojsa Çović, përfaqësues i kryetarit të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) nënshkruan “Dokumentin e përbashkët” ndërmjet UNMIK-ut dhe RFJ-së. Dokumenti në fjalë është bërë me qëllim të ngritjes së pjesëmarrjes së serbëve në gjyqësi, polici dhe administratë publike. Me të garantohet e drejta e serbëve për arsim në gjuhën e tyre, përfshirë nivelin e lartë (Dokumentin e përbashkët UNMIK- RFJ, Beograd 2001). Megjithatë, ka qenë Plani prej shtatë pikave i PSSP-së, Michael Steiner, që bindshëm i dha nismën procesit të

decentralizimit si të tillë<sup>4</sup>. Steiner, atëbotë prezantoi planin e tij një javë para zgjedhjeve lokale, në synim për të nxitur serbët të marrin pjesë në zgjedhje, gjë e cila nuk ndodhi. Megjithatë, përkushtimi ndaj decentralizimit i PSSP-së Steiner nuk mbaroj me kaq. Ai inicioj diskutime për procesin e decentralizimit nga i cili

**Pasi që të zbehet rreziku që serbët tani e perceptojnë, do vijë në shprehje realitetet e hidhura ku do të mund të ketë serbë që kërkojnë të përfshihen në komuna më të mëdha.**

<sup>2</sup> I përbërë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Italia, Gjermania dhe Rusia.

<sup>3</sup> Shih KIPRED, Procesi i Statusit të ardhshëm të Kosovës: Anketimi Njohuritë-Praktikat- Qëndrimet, korrik 2006, (gjendet: [http://kipred.net/UserFiles/File/Kosovo\\_Future\\_Process\\_KAP\\_Survey\\_Report.pdf](http://kipred.net/UserFiles/File/Kosovo_Future_Process_KAP_Survey_Report.pdf)).

<sup>4</sup> “Një zgjidhje për Mitrovicën – Plani prej shtatë pikave”, Komunikatë për shtyp e UNMIK-ut. 1 tetor 2002. (gjendet në: <http://www.unmikonline.org/press/pressr02.htm> (4 nëntor 2006).

të gjitha komunat do të përfitonin dhe ftoj Këshillin e Evropës të paraqes propozime për decentralizimin<sup>5</sup>.

Ngjarjet e marsit 2004 kanë vënë në sprovë kapacitetet e sigurisë në Kosovë dhe shtuan frikën në radhën e serbëve të Kosovës (ICG, raporti nr. 155, 2004). Serbia e shfrytëzoi këtë për të akuzuar institucionet e Kosovës dhe kërkoi nga bashkësia ndërkombëtare që pa vonuar të fillohet procesi i decentralizimit në mënyrë që të krijohet autonomia serbe në Kosovë (Danas, 2004). Gjendja e re vuri në pah shqetësimet ndëretnike dhe shtroj nevojën për t'u marrë me këto shqetësime, në radhë të parë zgjidhjeve të avancuara institucionale. Bashkësia ndërkombëtare reagoj duke pranuar decentralizimin si mekanizmin më të mirë për t'iu përgjigjur shqetësimeve dhe me këtë qëllim në mendje filloj presionin për të fituar pëlqimin e institucioneve kosovare.

Bashkësia ndërkombëtare ka synuar që Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të marrin pronësinë mbi procesin e decentralizimit. Përkundër kësaj, udhëheqësit vendorë fillimisht ishin të përmbajtur para idesë së decentralizimit. Duke shpresuar që decentralizimi do të neutralizoj arsyetimin e serbëve për të bojkotuar institucionet (dhe peshën e kësaj çështjeje për statusin), udhëheqësit kosovarë më vonë u pajtuan të zbatojnë decentralizimin.

Në mars 2005 Qeveria e Kosovës miratoj planin e decentralizimit. Mbështetur në dokumentin kornizë për reformën e pushtetit lokal, të miratuar në korrik 2004, Qeveria pranoi nevojën për forcim të ndjenjës së pronësisë dhe llogaridhënie të shtuar në nivelin lokal. Për këtë qëllim u themelua Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), e ngarkuar me detyrë për të hartuar planin për zbatimin e decentralizimit dhe për të përmirësuar bashkërendimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre komunale. Sipas planit të Qeverisë së Kosovës u zgjodhën pesë komuna si pilot-projekte, si formë e demonstrimit të përkushtimit ndaj procesit në fjalë. Për të dëshmuar se procesi është edhe në të mirë të shqiptarëve, u përzgjedhën dy komuna me shumicë shqiptare, Hani i Elezit dhe Juniku, dy me shumicë serbe, Graçanica dhe Parteshi. Komuna e pestë e përzgjedhur është Mamusha, me popullsi shumicë të etnisë turke (Urdhëresa Administrative 2005/11).

**Serbia e shfrytëzoi këtë për të akuzuar institucionet e Kosovës dhe kërkoi nga bashkësia ndërkombëtare që pa vonuar të fillohet procesi i decentralizimit në mënyrë që të krijohet autonomia serbe në Kosovë.**

Në vigjilje të bërjes publike të pakos për statusin e ardhshëm të Kosovës dhe të fillimit të jetësimit të decentralizimit kosovarët e shohin këtë proces si jo mjaft transparent, dhe për pasojë ekzistojnë perceptime tejet negative të këtij procesi (shih Figurën 1). Siç vë në pah shefja e grupit parlamentar të AAK-së, “Ekipi i Unitetit është dashur të bëjë punë më të mirë në shpjegimin qytetarëve të pasojave të decentralizimit. Ekipi i Unitetit është dashur të punoj më shumë me kryetarët e komunave dhe me vetë qytetarët” (Syla 2006). Mënyra më e shpeshtë e të kuptuarit të decentralizimit ndër shqiptarët e Kosovës ka të bëjë me përshtypjen e imponimit të procesit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe se i njëjti është çmim që duhet paguar për të fituar pavarësinë (Ibrahimi, Kuçi, Mujota 2006). Disa e shohin decentralizimin si uverturë për ndarje të Kosovës. “I ashtuquajturi ‘decentralizim’ shërben për të ndarë Kosovën dhe për t’i pasur ato nën udhëheqje qendrore nga Beogradi” (Xhemajli 2006). Si i tillë ky proces shihet si një rrezik i mundshëm për integritetin territorial të Kosovës. “Kjo formë e decentralizimit as që është duke ndodhur për të kënaqur interesat e

<sup>5</sup> Për një shqyrtim kritik të propozimit të Këshillit të Evropës, shih: [www.kipred.net](http://www.kipred.net).

të gjithë serbëve të Kosovës, por për kërkesat e politikës së Beogradit, politikë kjo që shkon kundër çfarëdo stabiliteti në Kosovë” (po aty). Për më tepër, shpeshherë pohohet se “krijimi komunave të reja po bëhet përgjatë vijave etnike dhe kjo do të jetë e vështirë të funksionoj”. (Krasniqi, 2006).

### 3. KONFUZIONI RRETH DECENTRALIZIMIT

Pasiguria në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës përbën pengesën më të madhe për negociimin e decentralizimit në Kosovë. Si pasojë e kësaj, propozimi i Delegacionit të Kosovës mbështeten në premisën thelbësore të Kosovës së pavarur. Të gjitha propozimet e delegacionit të Kosovës të paraqitura gjatë bisedimeve në Vjenë mbështeten në supozimin se statusi i ardhshëm do të jetë pavarësia. Ky përkushtim i kushtëzuar ndaj decentralizimit do të përballet me sfidën më të madhe në rast se statusi i ardhshëm përmban çfarëdo shkalle të paqartësisë.

#### **Për shumë nga shqiptarët decentralizimi shihet si i imponuar nga bashkësia ndërkombëtare për të kënaqur Serbinë dhe interesat e serbëve në Kosovë.**

Duke rikonfirmuar Parimet Udhëzuese për statusin e ardhshëm të Kosovës, Grupi i Kontaktit muaj më parë, pas emërimit të Përfaqësuesit të posaçëm, Martti Ahtisaari, duke përjashtuar mundësinë e kthimit të Kosovës nën kontrollin e Serbisë, ndarjen e Kosovës apo bashkimin me ndonjë vend tjetër.

Deklarata në fjalë gjithashtu thekson se “dispozitat e efektshme për decentralizimin e Kosovës do të jenë thelbësore për zgjidhjen e statusit” (Grupi i Kontaktit 2006). Grupi i Kontaktit se zgjidhja e ardhshme duhet të marrë parasysh çështje të tilla si “liria e lëvizjes, transparenca dhe lidhjet konstruktive ndërmjet bashkësive serbe në Serbi dhe Kosovë, mekanizma për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur dhe pako masash për mbrojtjen e bashkësive dhe objekteve fetare” (po aty). Në të njëjtën frymë, kërkohet që pjesë e zgjidhjes së statusit të jenë mekanizma të marrëdhënive të mira dhe të fqinjësisë së mirë ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Në nëntor 2005, Delegacioni i Kosovës miratoj dokumentin e parimeve dhe qëndrimeve në lidhje me bisedimet për statusin përfundimtar<sup>6</sup>. Dokumenti përcakton platformën për bisedime, duke theksuar, ndër të tjera, nevojën për përmbylljen e procesit të zgjidhjes së statusit gjatë vitit 2006 dhe se statusi përfundimtar duhet të pasqyroj vullnetin e kosovarëve për pavarësi. Dokumenti në fjalë është lënë anash pasi që bërja publike e statusit është shtyrë së paku deri në shkurt të këtij viti, dhe statusi pritet të qartësohet gjatë muajve të ardhshëm. Dokumenti gjithashtu pranon rëndësinë e decentralizimit si mekanizëm i avancimit të të drejtave të bashkësive në Kosovë. Në lidhje me këtë institucionet e Kosovës janë përkushtuar për të përgatitur kornizën e domosdoshme ligjore, me qëllim të reformimit të qeverisjes lokale.

Bisedimet e drejtpërdrejta ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që filluan në shkurt të vitit 2006 filluan në Vjenë, fillimisht u përqendruan në të ashtuquajturat “çështje teknike”. Këto çështje teknike përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, çështje financiare etj. Tema më e ndjeshme, sipas të gjitha gjasave ka qenë ajo e decentralizimit. Delegacioni serb ka propozuar krijimin e një numri të madh të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Ata

<sup>6</sup> Dokumenti për bisedimet rreth statusit i Delegacionit të Kosovës (i njohur edhe si Platforma për bisedime e Delegacionit të Kosovës), drejtuar Martti Ahtisaari-t, miratuar më 22 nëntor 2005. Për përmbajtjen e dokumentit shih “Express”, 23 nëntor 2005, fq. 6-7.



gjithashtu kanë insistuar në ndarjen e qytetit të Mitrovicës, në pjesën me shumicë serbe në veri të lumit Ibër dhe në pjesën me shumicë shqiptare në jug. Sipas propozimeve të bëra, këto komuna do të duhej të jenë të kontrolluara nga autoritetet komunale serbe, të kenë policinë e tyre lokale dhe të lidhura ngushtë ndërmjet veti dhe me Serbinë. Në anën tjetër, delegacioni kosovar beson të ketë qenë bujar në ofertën për 5+1 komuna me shumicë serbe.

Përderisa bisedimet rreth decentralizimit zhvilloheshin në anën tjetër pakënaqësia shtoi radhën e grupeve të ndryshme. Në një numër komunash janë organizuar protesta, shpeshherë të udhëhequra nga lëvizja “Vetëvendosja”.

Lëvizja në fjalë vazhdimisht ka shprehur pakënaqësinë dhe kundërshtimin me decentralizimin në Kosovë. Sipas udhëheqësit të “Vetëvendosjes”, Albin Kurti “procesi i decentralizimit i negociuar në Vjenë nuk është decentralizim i mirëfilltë dhe nuk paraqet bartje të pushtetit në të mirë të qytetarëve, por është centralizim dhe zgjerim i ndikimit të Beogradit në enklavat, të cilat vetëm sa do të fuqizohen më tepër” (Kurti, 2006). Sikurse Kurti, ka mjaft hisedarë të tjerë të cilët të cilët kundërshtojnë decentralizimin, ashtu siç trajtohet më tutje në punim.

### **Disa grupe të interesit kundërshtojnë decentralizimin duke e konsideruar atë rrezik për integritetin territorial të Kosovës.**

Ndonëse decentralizimi është promovuar si proces që do e sjellë Kosovën më afër synimit të shoqërisë multietnike, ky proces kryesisht shihet si ri-caktim i kufijve të komunave përgjatë vijave etnike. Sipas delegacionit të Kosovës, ata janë përpjekur t’u ikin pretendimeve territoriale të Serbisë në Kosovës përmes lejimit të krijimit të komunave të reja me shumicë serbe. Siç vë në pah zëvendës-kryeministri i Kosovës “e mira dhe e keqja e decentralizimit në Kosovë është se ka eliminuar aspektet territoriale nga njëra anë, por në anën tjetër ka forcuar parimit etnik” (Haziri 2006). Në të vërtetë, parimi etnik është njëra nga arsyet pse disa grupe interesi të shqiptarëve të Kosovës kundërshtojnë këtë proces. Gjilani ka kaluar nëpër tensione të ndryshme për shkak të decentralizimit përgjatë vijave etnike, duke pohuar se shumica e territorit të komunës do të ndahen dhe kjo do e bënte komunat të


**“Nëse decentralizimi i kësaj natyre është çmim për pavarësinë, atëherë ai është një çmim shumë i lartë”.**

paqëndrueshme. Degët e të gjitha partive politike relevante dhe një numër organizatash të ndryshme fuqimisht kanë kundërshtuar ekipin negociator të kosovarëve dhe i kanë akuzuar ata për nxitje të ndarjes së Kosovës. Këshilli i protestave i qytetit, duke qenë kundër propozimit të hartuar nga Ekipi i Unitetit ka kërkuar dorëheqjen e këtij Ekipi. Kreu i PDK-së në Gjilan, Qemajl Mustafa ka theksuar se propozimi i

decentralizimit do të kufizoj komunën në 400 kilometra katror, për një popullsi prej rreth 130.000, ndërsa komunat me rreth 12.000 banorë do të marrin nga 230 kilometra katrorë. “Decentralizimi do t’i heq Gjilanit një pjesë të madhe të territorit, do ta privoj atë nga toka punuese e burimet e ujit dhe qyteti do të mbetet pa asgjë. Përveç kësaj, si pasojë e decentralizimit çfarë po bëhet, rrugët kryesore të komunikimit do të bllokohen” (Mustafa 2006). Grupe aktivistësh kundër decentralizimit të komunës pohojnë se “nëse decentralizimi i kësaj natyre është çmim për pavarësinë, atëherë ai është një çmim shumë i lartë” (Kurteshi 2006). Të njëjtut kanë grumbulluar rreth 30.000 nënshkrime të qytetarëve të cilët kategorikisht kundërshtojnë decentralizimin përgjatë kufijve etnik.

Siç shihet, një nga vështirësitë kryesore në lidhje me decentralizimin ka të bëjë me perceptimet. Institucionet e Kosovës janë ndjerë nën presion nga bashkësia ndërkombëtare për të treguar përkushtim ndaj saj dhe serbëve. Por, në anën tjetër, këto institucione kanë

dështuar në shpjegimin shumicës së qytetarëve pse ata nuk mund të llogarisin në përfitime të menjëhershme nga decentralizimi dhe se ky është proces për të cilin do të nevojitet së paku një dekadë apo edhe më shumë.



**Tabela 1. Opinioni publik për çështjen e decentralizimit<sup>7</sup>**

Ndjenja e përgjithshme për decentralizimin ndryshon brenda spektrit të vendimmarrësve. Ekzistojnë ata që kategorikisht kundërshtojnë atë dhe të tjerët të cilët e shohin decentralizimin si një çmim të pashmangshëm për pavarësinë. Për IPVQ-të dhe shumicën e partive politike decentralizimi ka rëndësi thelbësore si një mjet negociues për pavarësinë. Megjithatë, ndër shqiptarët e Kosovës një numër i entiteteve të ndryshme fuqimisht kundërshtojnë decentralizimin. Udhëheqësia kryesore politike në rajonin e Anamoravës (Gjilan, Viti, Artanë/Novobërdë) besojnë se decentralizimi do të shkaktoj mosfunksionimin e komunave të tyre gjegjëse. E njëjta mënyrë e të menduarit është e pranishme edhe në vende të tjera, si bie fjala në Viti. Kryetari i kësaj komune shprehimisht pohon se nuk do ta zbatoj planin e decentralizimit: “le ta vijnë [qeveria qendrore] ta zbatojnë (Misini 2006). Në këtë mënyrë, udhëheqësia komunale është vënë kundër planit të decentralizimit, duke e konsideruar atë si të padrejtë, të imponuar dhe të tillë që shkakton barrë të rëndë financiare për buxhetin e komunave.

Në anën tjetër, serbët e Kosovës përgjithësisht përkrahin decentralizimin, ndonëse varësisht nga vendbanimi i tyre kanë pritje të ndryshme nga ky proces. Përderisa për shumë serbë në veri qëllimi është çimentimi i ndarjes së tanishme faktike, në pjesë të tjera të Kosovës përkrahja e serbëve për decentralizim nxitet nga një numër arsyesh legjitime. Këto interesa,

<sup>7</sup> Proces i statusit të ardhshëm të Kosovës: Hulumtimi Njohuritë-Qëndrimet-Praktikat. Të dhëna të mbledhura ndërmjet 10 dhe 20 maj 2006. Intervistat janë zhvilluar me një numër nën-grupesh të hetuesve: shqiptarë të Kosovës (N=753); serbë të Kosovës (N=485); të zhvendosur serbë që jetojnë në Serbi (N=248); kosovarë të tjerë (N=300); serbë të Serbisë (N=795); dhe të tjerë nga Serbia (N=100).

ndër të tjera, përfshijnë vendosjen për çështje të arsimit, shëndetësisë, zhvillimit lokal, sigurisë dhe gjyqësisë.

Përveç shqiptarëve dhe serbëve edhe një numër i palëve të tjera është i përfshirë në procesin e decentralizimit dhe sjelljet e atyre palëve do të ndikojnë procesin në një mënyrë apo në tjetrën. Beogradi ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në bisedimet e Vjenës, në përpjekje për të siguruar autonomi për serbët e Kosovës dhe për të parandaluar pavarësinë e Kosovës. Për Beogradin, decentralizimi është cilësuar si “kusht vital që mundëson mbijetesën, sigurinë dhe kthimin [e serbëve të Kosovës]” (Rasković-Ivić, 2006)

Përveç hisedarëve të lartpërmendur, bashkësia ndërkombëtare mbetet faktorë i rëndësishëm në këtë proces. Nga ana e pjesëve të ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare procesi i decentralizimit shihet si qenësor për zhvillimin normal të shoqërisë kosovare. Në të vërtetë, bashkësia ndërkombëtare paraqet shtytësin kryesor të decentralizimit. Pjesë të ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare (si Grupi i Kontaktit, UNOSEC, etj.) e shohin decentralizimin si qenësor për zhvillimin normal të shoqërisë kosovare. Në zbatimin e këtij procesi, krahas Grupit të Kontaktit, pritet që Zyra Civile Ndërkombëtare të ketë përfshirje me peshë. Kjo zyrë, sipas të gjitha gjasave do të ketë rol të rëndësishëm, veçanërisht duke thënë fjalën e fundit për rastet e kontesteve ndërmjet palëve.

Me këtë shumësi të palëve të përfshira në proces, ku secila është e shtyrë nga ide dhe pritje të ndryshme, rezultatet e pritura bëhen mjaft të pasigurta.

#### **4. DECENTRALIZIMI DHE ÇËSHTJET KRYESORE PËR DISKUTIM**

Procesi i decentralizimit vazhdon të jetë shumë i politizuar. Disa politikan pohojnë se “ka qenë gabim strategjik asocimi i decentralizimit vetëm me serbët dhe moskuptimi i saj si diçka prej të cilës të gjithë përfitojnë” (Ivanović 2006). Sipas kësaj pikëpamje po ashtu ka qenë gabim trajtimi i decentralizimit si temë kryesore e negociatave mbi statusin final dhe për shkak të kësaj të gjitha palët do reagojnë në mënyrë negative (Ivanović 2006). Një nga të metat kryesore të procesit aktual është ndjenja e përhapur e mungesës së informatave. Përderisa ka mangësi në sigurimin e duhur të rrjedhjes së informatave në mes të hisetarëve relevant dhe në përgjithësi në publik, është jo reale që të pritet më shumë para se të merren vendimet dhe para se pakoja e statusit të ardhshëm, përfshirë decentralizimin, të bëhen publike.

Bazuar në draftin e fundit të planit të decentralizimit dhe përshtypjeve të opinionit publik, është e mundshme të nënvizohen disa nga çështjet kryesore që kanë të bëjnë me procesin. Sipas dokumentit të propozuar, qëllimet kryesore të decentralizimit në Kosovë janë:

- a) *Adresimi i shqetësimeve legjitime të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera jo shqiptare;*
- b) *Përmirësimi i qeverisjes së mirë dhe efikasitetit të shërbimeve publike nëpër tërë Kosovën;*
- c) *Përmirësimi i parimit të subsidiaritetit si thelbësore në ndërtimin e sistemit të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale*<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Dokumenti i propozuar nga UNOSEC-u akoma është akoma subjekt i ndryshimeve dhe nuk është arritur marrëveshje për përmbajtjen e saj finale.

Siç edhe theksohet në dokument, ky proces në rend të parë ka për qëllim qetësimin e serbëve (dhe në një shkallë më të vogël të komunitetet tjera joshqiptare). Përderisa në parim nuk është asgjë problematike me një gjë të tillë, pasi që decentralizimi shpesh ka të bëjë me adresimin e mosmarrëveshjeve të komuniteteve pakicë, është përshtypje e tillë brenda komunitetit shumicë se ai mund të nxisë tensione të ardhshme. Vetë ideja e parimit të subsidiaritetit (dhe si rrjedhojë decentralizimin) është që t'u shërbejë interesave të ndryshme dhe kjo nuk aplikohet në shoqëritë homogjene por në ato heterogjene. Sidoqoftë, është e kuptueshme që shqiptarët jashtë Prishtinës nuk do të kenë shumë interesa të cilat dallojnë nga ato të Prishtinës në këtë fazë kur statusi nuk është i zgjidhur, kështu që ata vetvetiu do të shohin pak arsytim për bartje të përgjegjësive në nivelin lokal.


Sipas shumë vendimmarrëseve qëllime tjera, forcimi i qeverisjes së mirë, etj., janë vendosur si nën-standarde të qëllimit kryesor. Qëllimi i parë si i tillë, edhe në dokument edhe në qasjen e përgjithshme kundrejt decentralizimit, përfshirë në dokumentin e decentralizimit është shkaktari kryesor i frikës dhe mospajtimit në mesin e disa grupeve të interesit të shqiptarëve të Kosovës të cilët haptazi janë kundër këtij procesi. Duk pasur parasysh që komponenti etnik krahasuar më të tjerët është më i rëndësishëm, atëherë përforcohet bindja që i tërë procesi është i bazuar etnikisht dhe do të qoj në ndarje etnike.

Se ka të bëjë shumë me komunikimin e zgjidhjeve përkatëse shihet nga përgjigjet e ndryshme të dhëna nga të anketuar të ndryshëm lidhur me decentralizimin dhe me devoluimin e kompetencave. Të pyetur nëse “autoriteteve lokale duhet tu jepet sa më shumë përgjegjësi që është e mundur, në mënyrë që nevojat e qytetarëve të jenë të adresuara nga ata që i kuptojnë më së miri këto nevoja” (shih figurën 2), edhe shqiptarët edhe serbët në parim e kanë përkrahur një gjë të tillë. Përveç pajtimit për përfitimet e decentralizimit duket të ketë një dyshim lidhur me drejtimin politik të tij. Përderisa shqiptarët përkrahin bartjen e kompetencave dhe mendojnë që decentralizimi do të përmirësojë shërbimet publike, pak nga ta përkrahin decentralizimin kur i referohen si të tillë. Serbët në anën tjetër në masë të madhe përkrahin “decentralizimin” por jo për arsye se aftësisë së tij për ta përmirësuar qeverisjen lokale (po aty).

## **Figura 2. Opinioni publik mbi decentralizimin kundrejt transferimit të kompetencave<sup>9</sup>**

---

<sup>9</sup> RTI – USAID, Perceptimet e qeverisjes lokale në Kosovë, 2005 (Përgatitur nga KIPRED).



***a. Krijimi i komunave të reja me shumicë serbe***

Që nga fillimi i procesit të decentralizimit, krijimi i komunave të reja me shumicë serbe është parë nga politikanët kosovarë si lëshim i vështirë ndaj serbëve. Siç është thënë më lartë, shqiptarët e Kosovës frikësohen se arsyeja kryesore prapa krijimit të komunave me shumicë serbe ka të bëjë me qëllimin për të paralizuar institucionet qendrore dhe për të krijuar autonomi të plotë brenda rajoneve të banuara me serbë.

Në rast të skenarit të tillë, shqiptarët e Kosovës frikësohen se pasi këto enklava të shndërrohen në komuna dhe të krijojnë lidhje territoriale ndërmjet veti, ato pastaj mund të kërkojnë autonomi të veçantë brenda Kosovës dhe *de facto* ndarje të Kosovës, apo krijimin e një rajoni serb, njëjtë sikur Republika Serbe në Bosnjë. Këto supozime ngritin frikën që shteti i ardhshëm i Kosovës do të jetë i paralizuar dhe jofunksional (Xhemajli 2006). Pos kësaj, shqiptarët e Kosovës frikësohen se “decentralizimi do të krijojë enklava shqiptare brenda komunave me shumicë serbe me ç’rast shqiptarët do të bëhen pakicë” (Kurti 2006). Në përgjithësi shqiptarët e Kosovës frikësohen se decentralizimi do të shërbejë si hyrje në skenarin boshnjak të entiteteve të ndara.

Serbët, për dallim nga shqiptarët, kanë insistuar në fitimin e komunave të tyre. Vetëm përjashtëmish mund ta dëgjosh ndonjë kritik në mesin e tyre për karakterin etnik që fshihet prapa komunave të reja, gjë që tregon se është pikërisht kjo ajo çka ata presin nga ky proces. Siç e ka theksuar një lider i serbëve të Kosovës, serbët do të kishin qenë “të interesuar të kenë disa komuna ku shqiptarët do të ishin pakicë, kështu që ata [shqiptarët e Kosovës] do ta ndjenin këtë dhe kështu do të krijonin një mirëkuptim për nevojat e pakicave në përgjithësi. Ky do të ishte një test i mirë edhe gjithashtu edhe për serbët dhe do të mund të shihnim se si do të sillleshin ata si shumicë” (Ivanoviq 2006). Përderisa pikëpamje të tilla janë të pakta, për serbët e Kosovës procesi i decentralizimit dhe krijimi i komunave të reja me shumicë serbe (përgjatë vijave etnike) ishte parë si thelbësore për përmirësimin e gjendjes kritike të komunitetit serb që jeton në Kosovë, veçanërisht në aspekt të lëvizjes së lirë dhe shfrytëzimit të shërbimeve që duhet t’i ofrojnë autoritetet komunale. Përveç kësaj decentralizimi për serbët shihet si kritik për qëndrueshmërinë demografike në aspektin afatgjatë. Arsye tjera

praktike po ashtu kanë ndikuar shtytjen për decentralizim, siç është p.sh. kryerja e shërbimeve është më e lehtë përmes lidhjeve (njëjtë sikur për shqiptarët), kështu që serbët që kanë me pak lidhje në komunat shqiptare shohin me pak mundësi që të kryejnë shërbime. Për më tepër, njëjtë sikurse për shqiptarët, dhënia e vendeve të punës dhe tenderëve është një nga burimet kryesore për fuqi politike, që në mënyrë të kuptueshme shumë liderë serbë e dëshirojnë për vete, p.sh. në nivel që ata mund ta kontrollojnë.

Përmes komunave të reja, serbët e Kosovës presin të kenë kompetenca në fushat që i prekin drejtpërsëdrejti nevojat e tyre, saktësisht kujdesin shëndetësor, arsimin, policinë dhe gjyqësinë, etj. (Nojkiq 2005). Për më tepër si anëtar i ekipit negociator të Serbisë, Leon Kojen, ka thënë se qëllimi i Serbisë ishte përqendruar në “përpjekjet për të përdorur procesin e decentralizimit në mënyrë që të mbrohet komuniteti serb dhe të mundësohet kthimi i refugjatëve në provincë” (Kojen 2006). Tutje, përmes strukturave ku ata përbëjnë shumicën, serbët shohin një mundësi të hapur për lidhje institucionale të papenguara me Beogradin. “Ne dëshirojmë lidhje të drejtpërdrejta institucionale ndërmjet Beogradit dhe komunave serbe. Në fusha të caktuara ne jemi duke planifikuar ndihmë më të madhe për komunat me shumicë serbe, veçanërisht në fushën e kujdesit shëndetësor, arsimit, fesë, trashëgimisë kulturore”, ka thënë këshilltari i kryetarit serb në një konferencë për media në Vjenë. Në këtë mënyrë, decentralizimi nga pikëpamja serbe është udhëhequr nga shqetësime legjitime të përziera me qëllimin për të pasur sa më pak që është e mundur varësi apo bashkëpunim me institucionet ku shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën.

Në masë të madhe besohet se për shkak të qëllimit të decentralizimit në Kosovë si pazarllëk për t'i qetësuar serbët në prag të zgjidhjes së statusit final të Kosovës, disa nga kriteret standarde të përdorura në vendet tjera për krijimin e komunave të reja janë anashkaluar në rastin e Kosovës. Për shembull, qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare të konsideruara kudo si kriteret parësore, besohet që në Kosovë të kenë rënë në pozitë dytësore. “Aspektet etnike, demografike dhe gjeografike të një regjioni/grupi të fshatrave kanë qenë në mesin e kriterëve për krijimin e komunave në Kosovë” (Mujota 2006). Edhe pse është ngritur shpesh si çështje, si e tillë ajo nuk përbën ndonjë kërcënim të rëndësishëm. Argumenti se komunat në zonat rurale mund të jenë shumë më të vogla sesa ato në zonat urbane ka të bëjë me homogjenitetin/heterogjenitetin e nevojave të popullatës. Përveç kësaj, janë komunitetet lokale që kërkojnë më shumë kontroll të burimeve, një çështje që duhet të merret parasysh.

Sidoqoftë, fakti që shumë vendimmarrës shqiptarë të Kosovës e përmendin këtë si problem tregon: (a) injorim i nevojave të serbëve, (b) frikë nga roli i Beogradit.

**Rrjedhimisht, pasi që të zbehet rreziku që serbët tani e perceptojnë, do vijnë në shprehje realitetet e hidhura ku do të mund të ketë serbë që kërkojnë të ri-integrohen në komuna më të mëdha.**

Si të krijohen këto komuna dhe të filloj funksionimi i tyre, qëndrueshmëria e tyre do të vihet në provë. Rrjedhimisht posa të shmanget rreziku që serbët tani e perceptojnë, realitete të mundimshme do të vijnë në shprehje dhe disa serbë do të kërkojnë të ri-integrohen në komuna më të mëdha. Në të ardhmen,

numër gjithnjë e më i madh i shërbimeve do të varet në “të hyrat vetanake” dhe ato komuna që nuk kanë një bazë solide të sistemit të taksave nuk do të jenë të gatshme të ngritin fonde dhe do të ofrojnë më pak shërbime për qytetarët e tyre.

Kompetencat e komunave të reja duket që do të sjellin konfuzion po ashtu, përderisa në këtë fazë mungon informata e dorës së parë për shumë hisetarë. Në fakt, kanalet e dobëta të

komunikimit në të gjitha nivelet dhe shkalla e lartë e pasigurisë për rreth rezultatit final të decentralizimit në mënyrë të konsiderueshme rrit dyshimin mbi tërë procesin e decentralizimit, motivet dhe rezultatet e mundshme të tij. Përveç listës mjaftë të plotë të kompetencave të tyre, komunat e reja po ashtu do të kenë edhe kompetenca të deleguara në: (a) shënimet kadastrale; (b) regjistrat civil (regjistrimin dhe dokumentacionin); (c) regjistrimin e votuesve; (d) regjistrimin e bizneseve dhe licencimin, (e) pagesat e ndihmave sociale; dhe (f) mbrojtjen e pyjeve. Përveç kompetencave të tyre dhe atyre të deleguara, komunat e reja do të kenë të ashtuquajturat “kompetencat komunale shtesë” në fushat e:

- d) *Kujdesit shëndetësor – primar dhe sekondar;*
- e) *Arsimin – të gjitha nivelet; (nuk është e sigurt nëse arsimi i lartë do të aplikohet vetëm në veri të Mitrovicës apo edhe në vendet tjera);*
- f) *Kultura, duke përfshirë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes mbi ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore, sikurse edhe përkrahjen për komunitetet fetare lokale;*
- d) *Mbrojtja sociale*<sup>10</sup>

Arsyeja e kësaj, kuptueshëm, qëndron në situatën momentale. Deri më tani serbët jashtë mase janë mbështetur në arsimin dhe edukimin e ofruar nga Serbia, dhe një gjë të tillë ata e kanë arritur vetë. Në një situatë të tillë do të jetë mjaft e vështirë që të largohet ajo çka ata e kanë udhëhequr vetë deri më tani. Pasi shqiptarët nuk do të pajtoheshin me çfarëdo niveli regjional, zgjidhja është gjetur në formë të “legalizimit” të kujdesit shëndetësor sekondar në nivelin e Graçanicës dhe të pjesës veriore të Mitrovicës. Përderisa kujdesi shëndetësor dytësor në Kosovë është i centralizuar në Ministri, kjo do të jetë një përjashtim që do të mund të kalonte në nivelin komunal në këto dy raste. “Asimetri” e njëjtë do të ndodhë me universitetin në Mitrovicë. Të dyja këto janë të arsyeshme duke pasur parasysh se serbët kanë humbur praninë e tyre urbane në Kosovë, dhe në këtë kontekst është para nevoja për të bartur disa përgjegjësi “qendrore” në qendrat e reja të serbëve, Mitrovicë dhe Graçanicë. Këta dy shembuj të decentralizimit asimetrik nuk paraqesin ndonjë problem serioz financiar duke pasur parasysh që ata i shërbejnë një popullate konsiderueshme. Problemi është i veçantë me simbolizmin e serbëve për t’u izoluar nga shqiptarët, por një gjë e tillë i dëmton ata më tepër sesa shqiptarët. .

**Një ndarje e paqartë e përgjegjësiwe ekskluzive dhe të përbashkëta do të vije në shprehje kur këto komuna nuk do të jenë në gjendje të ushtrojnë disa nga përgjegjësitë dhe projektet e tyre.**

Në këtë moment konfuzioni i dukshëm për komunat e reja dhe kompetencat e tyre mund të mos duket problematik, por vështirësitë reale do të fillojnë të shfaqen gjatë fazës së miratimit të legjislacionit relevant dhe fillimit të zbatimit praktik. Një legjislacion i tillë duhet të hartohet me përfshirjen substanciale dhe aprovimin e përfaqësuesve të serbëve të Kosovës, prandaj pikëpamjet kundërshtuese dhe rezultatet do të vihen në sprovë serioze pothuajse në fazat e hartimit të legjislacionit të nevojshëm, si parakusht për zbatimin e pakos së decentralizimit. Bashkësia ndërkombëtare është duke u përpjekur që ta gjejë një zgjidhje që

<sup>10</sup> Lista e plotë e kompetencave të komunës sikurse si dhe kompetencave shtesë dhe të deleguara janë përmendur në versionin e pestë të dokumentit të UNOSEK-ut mbi decentralizimin ku po ashtu përfshihen edhe komentet e bëra nga delegacioni i Kosovës.

do t'i kënaqte të dyja palët. Sidoqoftë, është e arsyeshme që të pritet që qëllimi i fundit i krijimit të komunave të reja është adresimi i ankesave të serbëve të Kosovës. Duke pranuar krijimin e komunave serbe si një hap të nevojshëm, është e rëndësishme të sigurohet që kompetencat komunale do të jenë të barabarta në tërë Kosovën dhe ato nuk do t'a vejnë në pikëpyetje funksionimin normal të institucioneve të Kosovës.

Një vështirësi tjetër do të ketë të bëjë me financat. Një ndarje e paqartë e përgjegjësiive ekskluzive dhe të përbashkëta do të vije në shprehje kur këto komuna nuk do të jenë në gjendje të ushtrojnë disa nga përgjegjësitë dhe projektet e tyre. Prandaj, është e domosdoshme që donatorët të mund të financojnë ato gjatë tranzicionit të vështirë drejt një shteti të shëndoshë. Është po ashtu e domosdoshme që IPVQ-të të krijojnë kanale të mira të komunikimit me të gjitha komunitetet dhe komunat për t'u siguruar që probleme të tilla të vërehen me kohë. Probleme të ngjashme ekzistojnë edhe me komunat me shumicë shqiptare.

Përveç kësaj, në rastet kur me krijimin e komunave të reja janë shpërfillur kritere thelbësore, kjo do të bëhet e dukshme me mëkëmbjen dhe funksionimin e tyre. Për ato komuna që mund të mos qëndrojnë mirë, apo nuk janë efikase, ka të ngjarë që serbët lokal të fajësojnë institucionet qendrore. Këto të fundit do të marrin edhe kritika shtesë, qoftë nga opozita, "Vetëvendosja", apo nga publiku në përgjithësi që këto komuna në rend të parë nuk do të duhej të krijoheshin fare. Në raste të tilla kur një numër faktorësh me forcë relativisht të vogël mund të shndërrohen në aleanca të forta për t'a kundërshtuar decentralizimin.

Për bashkësinë ndërkombëtare decentralizimi si proces u bë i pashmangshëm duke pasur parasysh tensionet ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Nivelet e tensioneve dhe pozicionet kundërshtuese gjithnjë e më shumë dërguan tek nevoja për një izolim më të madh të komuniteteve. Ndarja e thellë shqiptaro-serbe e Kosovës, dhe frika e këtyre të fundit për eksod e ka shtyrë Ahtisarin që të krijoj dispozita të atilla të decentralizimit që në masë të madhe i izolojnë serbët e Kosovës nga Prishtina dhe i jep Beogradit ndikim të vazhdueshëm. UNOSEK-u shpreson që një gjë e tillë do të ndihmojë një tranzicion paqësor dhe të qëndrueshëm (ICG 2006). Përderisa izolimi mund të jetë praktik në aspektin afatshkurtër, tutje izolimi etnik e rrezikon vizionin afatgjatë të një shoqërie të integruar dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve që kjo mundohet t'i mbroj.

Burimi kryesor i kërcënimit ka të bëjë me kufirin e komunave të reja. Në disa raste udhëheqësit e komunave që do të "humbin" pjesë të territorit të tyre në komunat e reja kanë thënë haptazi se ata nuk do t'i njohin kufijtë e komunave të reja. Praktikisht kjo do të përfshijë përpjekje na liderët e këtyre komunave që të ushtrojnë autoritet në territorin që ligjërisht nuk është më në kompetencë të tyre.

### ***b. Qyteti i ndarë i Mitrovicës***

Mitrovica vazhdon të jetë problemi më i madh i Kosovës. Shtatë vite pas luftës, qyteti është i ndarë etnikisht në lumin Ibër ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb, edhe pse një gjë e tillë nuk reflekton përbërjen etnike që ka qenë para lufte. Të gjitha përpjekjet e gjertanishme për bashkimin e qytetit dhe integrimin e komunitetit serb në strukturat komunale të jugut kanë dështuar. Në vend të integritit, serbët e mbledhur në veri të lumit Ibër kanë krijuar dhe fuqizuar struktura të tyre paralele. Në shumicën e enklavave serbe, sikurse edhe në komunat në veri të Kosovës, administrata shtetërore serbe, gjykatat, shkollat, spitalet, etj., që janë përgjigjur në Beograd, kanë vazhduar të funksionojnë (Strukturat paralele, OSBE tetor 2003). Situata aktuale në qytet nuk lejon hapësirë për optimizëm më të madh dhe shpresa e




vetme për përmirësim mbetet brenda pakos për zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të Kosovës. Sidoqoftë, edhe oferta për dy komuna me një bord të vetëm të qytetit është refuzuar nga shumica e politikanëve, jo vetëm si e pabesueshme, por edhe rezultat i padëshiruar. Shumica e shqiptarëve të Kosovës e kanë të njëjtën pikëpamje (shih figurën 2). Qyteti i ndarë i Mitrovicës akoma perceptohet nga shumica e shqiptarëve të Kosovës si kërcënimi kryesor për integritetin territorial të Kosovës. Për serbët në anën tjetër, veriu i Mitrovicës paraqet qendrën e vetme urbane të cilën ata e kontrollojnë. Prandaj propozimi i delegacionit të Kosovës duke sugjeruar formimin e komunës së re në veri të Mitrovicës me konceptin “Një qytet – dy komuna” të qeverisura nga një “Bord administrativ i përbashkët i qytetit” i përbërë nga përfaqësues të komunave të veriut dhe jugut si dhe përfaqësues ndërkombëtarë (Pozicioni i delegacionit të Kosovës mbi çështjen e Mitrovicës, 2006). Sipas këtij plani komuna e re e formuar në veri të Mitrovicës do të funksionojë si komunë e rregullt me të gjitha kompetencat dhe obligimet që vijnë me të, duke përfshirë edhe organet e saja të zgjedhura për qeverinë lokale (kuvendin komunal, kryetarin e komunës). Qëllimi kryesor i Bordit të Përbashkët Administrativ do të ishte ribashkimi i qytetit në aspektin afatmesëm dhe disa kompetenca të kufizuara që kanë të bëjnë me qytetin në përgjithësi. Bordi do të merrte përsipër kompetencat e mbajtura nga administrata e UNMIK-ut dhe përqendrimi në ofrimin e sigurisë, shtetit ligjor, lirinë e lëvizjes dhe respektin për të drejtat e pakicave, shpërbërjen e strukturave paralele. Për shqiptarët e Kosovës Bordi do të jetë një trup ekzekutiv. Sidoqoftë, serbët e Kosovës nuk ndajnë të njëjtin mendim, ata besojnë që “ një trup i përbashkët duhet të bëhet sipas parimit të barazisë, ai do të merret me preokupimet e përbashkëta dhe do të ketë vetëm karakter konsultativ” (Ivanoviq 2006). Sipas kësaj pikëpamje, Bordi i Qytetit nuk do të jetë i ngarkuar me ndonjë funksion ekzekutiv.

**Delegacioni i Kosovës ka paraparë formimin e një komune të re në veri të Mitrovicës me konceptin “Një qytet dy komuna” që do të qeverisej nga një “Bord administrativ i përbashkët i qytetit” si një zgjidhje e përkohshme.**

Propozimi i delegacionit të Kosovës për qytetin e Mitrovicës është mirëpritur nga UNOSEK dhe si i tillë i ka arrit pritjet e bashkësisë ndërkombëtare (Express, maj 4, 2006). Zyrtarët komunal në jug të Mitrovicës thonë që plani i propozuar nga delegacioni i Kosovës në fakt është “maksimumi që mund të pranohet nga shqiptarët e Kosovës”. Për më tepër, ata fuqimisht kundërshtojnë idenë apo planin që sugjeron që komuna në veri të Mitrovicës mund t'i bashkohet komunës së Zveçanit (Imava dhe Ibrahim 2006). Zyrtarët e qeverisë qendrore argumentojnë se propozimi për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës ka lindur si një përpjekje për të integruar qytetin. “Ky propozim nuk nënkupton që ne do të legalizojmë ajo që quhet ndarje në terma gjeografik në lumin Ibër” ka theksuar z. Haziri, Ministër i Pushtetit Lokal. Ai ka argumentuar që “komuna e re në veri të Mitrovicës paraqet të vetmen qendër urbane ku serbët e Kosovës janë të mbledhur dhe formula kryesore drejt integritetit dhe bashkëpunimit është brenda planit të propozuar”. Pa marrë parasysh propozimin, deri me tani nuk ka shenja nëse serbët që jetojnë në veri të Mitrovicës do të pajtohen me këtë plan.

Frika kryesore me këtë plan është pasiguria rreth sjelljes së serbëve të Kosovës që jetojnë në veri pasi të merret vendimi mbi statusin politik përfundimtar të Kosovës. Udhëheqësit politik në veri të Kosovës fuqimisht kundërshtojnë mundësinë e pavarësisë së Kosovës. Kryetari i komunës së Zubin Potokut në veri të Kosovës ka deklaruar se “sa i përket çështjes së statusit final të Kosovës ne nuk do të pranojmë pavarësinë e saj sepse serbët e kanë shtetin e tyre” (S. Ristiq, Koha Ditore, 8 dhjetor, 2006). Kjo nënkupton që nëse Kosova do

të fitoj ndonjë lloj pavarësie atëherë varet shumë nga ajo se si do të përgjigjen serbët e Kosovës ndaj saj. Nëse ata e njohin dhe e pranojnë zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të Kosovës, atëherë plani për Mitrovicën ka gjasa të mira që të zbatohet. Por në rast se ata marrin ndonjë qëndrim tjetër, që nuk përputhet me zgjidhjen politike përfundimtare, atëherë pasiguria rreth bashkimit të qytetit dhe integrimi i komunitetit serb që jeton në veri do të rritet.



**Figura 2: Opinionii publik për Mitrovicën<sup>11</sup>**

Një nga rreziqet kryesore ka të bëjë me përshtypjet e ndryshme që kanë komunitetet nga Bordi Administrativ i Përbashkët i Qytetit. Në njëërën anë shqiptarët e Kosovës e konsiderojnë Bordin si mjet për integrim, ndërsa serbët në anën tjetër e konsiderojnë atë plotësisht si organ konsultativ<sup>12</sup>. Nga këto dy pozicione përjashtuese, presioni do të vihet në atë se si do të funksionojë Bordi dhe çfarë drejtimi duhet të merr ai. Rrjedhimisht, bllokadat e Bordit janë shumë të mundshme përderisa nuk ka mekanizma për t'i shmangur ato. Institucionet qendrore janë lënë pa çfarëdo mjetesh për ta lëvizur atë përpara drejt qëllimit të caktuar, që mund vetëm të dërgojë në mosbashkëpunim dhe në përforsimin e të dyja palëve në pozicionet e tyre. Kjo do të bëhet më e dukshme kur institucionet qendrore do të mundohen t'i përgjigjen presionit publik për integrim të veriut, përderisa do të bëhen më të vetëdijshëm për mungesën e mundësive reale të tyre. Pikëpamjet e ndryshme në lidhje me rolin e Bordit të Qytetit janë karakteristikë e pikëpamjeve kundërshtuese lidhur me gjerësinë dhe substancën e ndryshimeve që duhet të bëhen në qytet. Kështu që ka gjasa që ky rol t'i takoj Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO).

**Qëllimi kryesor i Bordit të Përbashkët administrativ do të ishte ribashkimi i qytetit në aspektin afatmesëm.**

Si përfundim, zbatimi i planit të propozuar për qytetin e Mitrovicës për arsye të ndryshme mbetet shumë i pasigurt. Nëse Kosova do të fitoj ndonjë lloj të pavarësisë atëherë varet shumë se si do të reagojnë serbët e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës. Nëse ata njohin dhe pranojnë zgjidhjen finale të statusit final të Kosovës, atëherë plani për Mitrovicën ka gjasa të mira që të zbatohet. Por në rast të marrjes së ndonjë qëndrimi tjetër, që nuk përputhet me zgjidhjen përfundimtare politike të Kosovës, do të rritet pasiguria për

<sup>11</sup> Procesi i statusit të ardhshëm të Kosovës. Analiza Njohuritë – Qëndrimet – Praktikak (KAP).

<sup>12</sup> While Kosovo Albanians see this body in charge for significant responsibilities, including issues related to security, Kosovo Serbs on the other hand would like to see it exercise only advisory functions.

bashkimin e qytetit dhe integrimin e komunitetit serb që jeton në veri. Situata momentale në tri komunat serbe në Kosovën veriore tregon se atje ka pak vullnet politik për të hequr dorë nga pozitat e pushtetit që pothuajse është krijuar dhe vendosjen e fatit të tyre në duart e një bordi të përbashkët, e lëre me më në institucionet qendrore. Për këtë arsye, bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria e Kosovës duhet të zhvillojnë skenarë për t'u marrë me situatën e parashikuar.

Përveç kësaj, të dy palët shikojnë me sy të ndryshëm në të ardhmen e Bordit të qytetit. Shqiptarët e Kosovës do të përpiqen të përdorin këtë Bord si një mjet për integrimin e pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës me pjesën tjetër të Kosovës. Serbët e Kosovës në anën tjetër do të përpiqen ose ta bëjnë Bordin me funksion të kufizuar, apo në mënyrë aktive ta bllokojnë apo ta bojkotojnë atë. Në çdo rast, përfshirja dhe roli i bashkësisë ndërkombëtare duhet të jetë i rëndësishëm në lidhje me Mitrovicën. Ajo duhet të përfshijë veprime kundrejt krijimit të besimit të mirë, t'ju përkujtoj palëve detyrat e tyre sikurse edhe ofrimi i interpretimeve të nevojshme për pakon e decentralizimit.

Kështu, kërcënimi kryesor do të mbetet ndarja e qytetit të Mitrovicës. Nëse situata ekzistuese e ndarjes *de facto* përforcohet edhe më shumë, atëherë ajo do të shërbejë si burim i përhershëm i jo stabilitetit për krejt Kosovën. Një gjë e tillë përfshin vazhdimin e veprimit të strukturave të Serbisë, një sfidë e drejtpërdrejt për autoritetet qendrore dhe një ndarje të thellë etnike.

### **c. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe bashkëpunimi me institucionet në Serbi**

Bashkëpunimi ndërkomunal i komunave me shumicë serbe dhe bashkëpunimi i tyre me institucionet në Serbi paraqet një tjetër çështje kundërthënëse. Brenga kryesore që shprehin kosovarët për këtë çështje është besimi se një lidhje e fortë në mes të komunave me shumicë serbe dhe e drejta për lidhje të drejtpërdrejta me Serbinë rrezikon integritetin territorial të Kosovës dhe përherë rrezikon lojalitetin e tyre ndaj Kosovës. Veç tjerash kosovarët druajnë që një bashkëpunim i tillë mund të bëhet një vegël për autonomi më të gjerë politike për komunitetin serb brenda Kosovës.

Përderisa Beogradi synon të ndajë Kosovën në entitetin shqiptar dhe në atë serb të lidhur me qeverinë serbe, Prishtina ka këmbëngulur për një shtet unik më të drejta maksimale për qeverinë qendrore (ICG 2006). Duke pasur parasysh këto interesa të ndryshme, UNOSEK-u ka përgatitur planin për decentralizim i cili do të lejonte lidhje vullnetare ndërkomunale për çështje si shëndetësia, arsimi dhe kultura (ICG 2006). Serbët e Kosovës bashkëpunimin ndërkomunal e shpjegojnë si nevoje praktike. Në këtë aspekt ata argumentojnë se “në qoftë se komunat (p.sh. Ranilluk, Novobërdë) dëshirojnë që së bashku të zhvillojnë një aktivitet për mbledhjen e mbeturinave, atëherë pse të mos u lejohet kjo”(Ivanović, 2006). Me të njëjtën arsye besohet se këto nevoja do të zbehen përgjatë kohës kur komunat do të bëhen më të fuqishme dhe do të jenë në gjendje të mbajnë përgjegjësitë mbi vete. Më shumë se kapacitetet, nevojat për bashkëpunim, do të treten me krijimin e sektorit privat. Komunat nuk kanë nevojë që të bashkohen për të ofruar shërbime, por të dyja mund të marrin këto shërbime nga sektori privat, i cili shpeshherë është më i lirë dhe me cilësor. Dilema kryesore nuk shfaqet në këtë nivel, por në nivelet më të larta, në atë se a mundën këto komuna të

lidhen mes vete me për të krijuar diçka si shtresë tjetër e qeverisjes, për të cilën shqiptarët janë fuqimisht kundër.

Dokumenti i propozuar për decentralizim, komunave të reja në Kosovë me shumicë serbe u njeh të drejtën për bashkëpunim ndërkomunal si dhe lidhjet e jashtme me Beogradin. Ky plan po ashtu thekson kriterin sipas së cilit ky bashkëpunim mund të bëhet, duke deklaruar se bashkëpunimi ndërkomunal dhe ai përgjatë kufijve duhet të aplikohet në pajtim me ligjet e nxjerra në Kosovë, kongreseve ndërkombëtare (Karta e Evropës për Vetëqeverisje Lokale, Kongresi i Madridit) dhe sipas një marrëveshje të veçantë në mes të qeverise kosovare dhe asaj serbe. Draft dokumenti i UNOSEK-ut për decentralizim i shtatorit të vitit 2006 ka parashikuar që një bashkëpunim i tillë mund të marrë formë financiare, teknike, ndihmë në ekspertizë dhe personel, si dhe ndihmë në zbatimin e të gjitha kompetencave të tyre. Veç kësaj komunat duhet të kenë të drejtë të lidhen, brenda fushëveprimit të tyre, me kolegët e tyre jashtë Kosove, përfshirë edhe institucionet në Serbi. Sipas praktikave të vendeve liberale, komunave nuk u nevojitet leja nga organet qendrore për të krijuar bashkëpunim me vendet përtej kufirit. Megjithatë, për t'iu shmangur konfliktit të mundshëm në mes të institucioneve qendrore dhe komunave me shumicë serbe, vendosja e një kriteri që do të garantonte transparencë dhe raportim mbi këto bashkëpunime do të ishin me vlerë. foster

Me aplikimin e këtyre masave një numër i dilemave do të shfaqen. Si do ti trajtojnë institucionet kosovare organet e krijuara nga komunat me shumicë serbe më qëllim të avancimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe mbajtjes së lidhjeve me Beogradin? Përderisa nuk ndryshon jo gatishmëria e institucioneve kosovare për të pasur ndonjë organ qeverisës të shtresë të tretë tensionet janë të pashmangshme. Serbët tanimë kanë formuar një asociacion dhe gjatë negociatave ata kanë insistuar për të pasur të drejtën e asociacioneve për të marrë kompetenca nga komunat me shumicë serbe. Duket qartazi se qëllimi është që asociacioni i komunave me shumicë serbe të mos synojnë asgjë më pak se rajonin, diçka që në mënyrë absolute kundërshtohet nga institucionet kosovare. Përderisa ideja është për decentralizim të përgjegjësive në mënyrë që komunitetet lokale ta kenë fjalën e vet në qeverisjen lokale, kjo mund të përfundojë me pushtet të centralizuar në këshillin e komunave serbe. Një gjë e tillë është shqetësuese duke u nisur nga fakti që komunat serbe tanimë kanë formuar një asociacion i cili nuk ka kurrfarë bashkëpunimi me institucionet qendrore. Për më tepër, këmbëngulja e serbëve gjatë negociatave për një asociacion të tillë që do të kishte kompetenca mbi komunat me shumicë serbe nuk synon asgjë më pak se rajoni. Në këtë fazë është vështirë të parashikohet nëse ndonjëra nga palët do të ketë motivim të mjaftueshëm për të vepruar në bazë të vullnetit të mirë, apo si do të reagojë nëse konsiderohet që pala tjetër është duke tejkaluar përgjegjësitë që kanë të bëjnë me bashkëveprimet ndërkomunale. Me palën e tretë të përfshirë në këtë ekuacion, Beogradin, veçmas nga institucionet kosovare dhe komunat me shumicë serbe, mundësia që gjërat të shkojnë mbrapsht vetëm rriten. Plani në vetvete nuk ka paraparë asnjë zgjidhje legale në rast të shkeljes së ndonjërës prej këtyre dispozitave. Dokumenti përshkruan gjithashtu edhe natyrën dhe mënyrat e ndryshme për bashkëpunimin funksional gjatë partneritetit por dështon në adresimin se çfarë masash janë të gatshme për të ndaluar çfarëdo dhune të shkaktuar brenda vendit <sup>13</sup>.

---

<sup>13</sup> Sipas dokumentit të propozuar dhe sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, komunat në Kosovë: do të kenë të drejtën për të bashkëpunuar duke krijuar, brenda fushës së kompetencave të tyre, partneritete bashkëpunuese për të kryer detyra të interesit të përbashkët (bashkëpunim funksional) si dhe të formojnë dhe

Shqiptarët e Kosovës janë të shqetësuar për këtë dispozitë sepse frikësohen se ajo do të krijoj probleme politike në vend të marrjes me çështje praktike. Në vend të komunave të decentralizuara përgjegjëse ndaj qytetarëve dhe institucioneve qendrore, frika qëndron në atë se do të kemi një nivel qendror të qeverisjes për serbët, ku institucionet qendrore qendrore kosovare do ta kenë të ndaluar të depërtojnë. Për më tepër kjo qendër më shumë duket të jetë e kontrolluar nga Beogradi. Ekziston shqetësim gjithnjë më i madh që ideja kryesore prapa krijimit të komunave të reja me shumicë serbe në Kosovë është lidhja e tyre territoriale. Megjithatë qeveria kosovare beson se ka parandaluar një gjë të tillë. Ndërsa Haziri pranon që në njëfarë mënyre komunat e reja janë të lidhura gjeografikisht mes vete, ai pohon se propozimi i tyre për krijimin e komunave të reja me shumicë serbe në qendër dhe në juglindje të Kosovës përjashton mundësinë për lidhje territoriale (Haziri, 2006). Si siguri kundër shkeljes nga institucionet qendrore, serbët e Kosovës duan të drejtën për krijimin e asociacioneve dhe të kenë lidhje institucionale me Serbinë të përcaktuara me kushtetutën e re të Kosovës, duke përfshirë të drejtën për kundërshtim të çdo ligji që në të ardhmen që është në kundërshtim me këtë garanci kushtetuese.

Propozimi për krijimin e Këshillit të Komunitetit Serb në Kosovë për të marrë përgjegjësinë për avansimin e interesave kulturore dhe politike të komunitetit serb që jeton në Kosovë paraqet një tjetër problem për shqiptarët e Kosovës. Këta të fundit ndjejnë se kjo mund të krijoj probleme shtesë për institucionet qeverisëse të Kosovës në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre. Disa i referohen kësaj si orvatje për “krijimin e një qeverie të vogël brenda Kosovës” (Kuçi 2006) dhe e shohin këtë si garë negative e cila duhet të **eliminohet**. Që një gjë e tillë të ketë sukses një dialog i mirë duhet të krijohet në mes të udhëheqësve nga të dy komunitetet që të zbusin frikën e të dy palëve.

Në përgjithësi, çështja e bashkëpunimit ndërkomunal duhet të konsiderohet si aktivitet normal që mund të zë vend në komuna të ndryshme dhe të shërbejë kryesisht vetëm për çështje praktike. Bashkëpunimet e tilla megjithatë duhet të jenë çështje të orientuara dhe të bazuara në vendimet e secilit kuvend komunal. Është shumë e rëndësishme të sigurohet se pavarësisht këtij lloji të bashkëpunimi kompetencat e komunave dhe përgjegjësitë ligjore të tyre mbesin fuqimisht nën komunat përkatëse. Nëse komunat e reja të serbëve të Kosovës do të mendojnë themelimin e një Këshilli dhe bartjen e kompetencave të komunës në të kjo me siguri do të qojë kah centralizimi i përgjegjësisë në bazë etnike. Prandaj, sa më shumë që të definohet çështja e këtyre marrëdhënieve ndërkomunale nga pakoja e dokumentit aq më pak do të ketë hapësirë për veprime dhe interpretime konfliktuoze që pala tjetër mund ta shoh si kërcënim.

**Për çështjen e komunave të reja frika kryesore me mundësi për konflikt qëndron në deklarin e komunave me shumicë serbe për autonomi territoriale**

Në rrafshin praktik kjo çështje duhet të konsiderohet si normale sepse është realiste të pritet një lidhje intensive në mes të komunave serbe. Edhe kjo çështje mund të krijoj frikë të kosovarët përderisa ka paqartësi dhe nuk ka siguri në statusin e ardhshëm politik të Kosovës dhe qëndrim pasues të serbëve kundrejt institucioneve.

---

marrin pjesë në një asociacion për të mbrojtur dhe promovuar interesat e përbashkëta (rolin e evokimit politik) Bashkëpunimi ndërkomunal është vullnetar dhe duhet të bazohet në vendimet individuale të komunave të prekura (UNOSEK, shtator 2006).

Burim kryesor i tensionit do të jetë nëse komunat me shumicë serbe do të shndërroheshin në autonomi politike dhe territoriale. Gjatë negociatave dhe komenteve në dokumentin e Ahtisari-t delegacioni serb vazhdimisht është referuar në autonomi. Kështu, deklarata unilaterale për autonomi territoriale mbetet kërcënimi më serioz në lidhje me komunat e reja.

#### ***d. Policia dhe gjyqësia***

Policia dhe gjyqësia janë dy shtyllat themelore për shoqërinë dhe në veçanti për komunitetet. Duke marrë parasysh gjendjen në terren, palët e përfshira në negociata për statusin përfundimtar të Kosovës kanë trajtuar këto çështje brenda kornizës së bisedimeve për decentralizim.

Zyrtarët nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Kosovës konsiderojnë që “kërkesat e serbëve për të zgjidhur shefat e policisë lokale nga ana e kuvendeve komunale është e pakuptimtë sepse një gjë e tillë duhet të jetë kompetencë e policisë në bashkëpunim me MBP-në”. Zëvendës-ministri i Punëve të Brendshme sugjeron se “duhet të ketë komision për të përzgjedhur tre kandidatë dhe në atë rast njëri prej tyre do të ishte i propozuar nga kryetari komunës, mirëpo prapëseprapë emërimin duhet ta bëjë MPB-ja” (Kuçi 2006). Në rast se kryetari i komunës nuk aprovon asnjërin prej tre kandidatëve, në atë rast MPB duhet të përpilojë një listë të re. Në rast se përzgjedhja për emërimin e shefit të policisë lokale dështon edhe pas raundit të dytë, kjo çështje pastaj duhet të kalon për shqyrtimin në nivelin e qeverisë qendrore e cila ka të drejtë të zgjedhë njërin nga kandidatët që ndodhën në listë. Ky filtër i mundëson kuvendit komunal që të jetë i përfshirë në përzgjedhjen e shefit të policisë lokale në komunat relevante. Sipas pikëpamjes dominuese të shprehur nga shqiptarët e Kosovës, shërbimi policor duhet të mbetet i centralizuar më qëllim të ruajtjes së funksionalitetit të tij.

Zgjedhja e kandidatëve në mënyrë të qartë duhet të sigurojë se asnjë individ i cili është i papranueshëm për palën tjetër të mos zgjidhet, dhe kjo nënkupton se i tërë procesi mund të zgjasë gjatë derisa të mos gjendet një person i pranueshëm për të gjitha palët. Prishtina duhet të sigurohet se asnjë polic lokal nuk do të mund të kalojë në forcë paramilitare apo të refuzojë zinxhirin komandues, ndërsa serbët dhe komunitetet tjera lokale duhet të kenë garanci se forca policore nuk do të përdoret si një mjet për të ushtruar represion.

**“Shërbimi policor i Kosovës duhet të mbetet i centralizuar me qëllim që të jetë funksional”**

Duke pasur parasysh nevojën për një baraspeshim të tillë, UNOSEK-u ka hartuar dokumentin për decentralizim i cili parasheh dispozitat e mëposhtme për kompetencat e policisë lokale:

- *Shërbimi policor i Kosovës i cili vepron në komuna do të jetë përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe ligjit në komuna;*
- *Përbërja etnike e policisë brenda komunës duhet që, brenda mundësive, të pasqyrojë përbërjen etnike të popullatës në atë komunë. Në parim, shefi i policisë lokale duhet të jetë pjesëtarë i komunitetit shumicë të asaj komune;*
- *Komanda e unifikuar e shërbimit policor duhet të ruhet në tërë Kosovën;*

- *Këshillat Lokale të përbëra nga përfaqësuesit e komunës dhe policisë duke përfshirë edhe shëfat e policisë lokale duhet të bëhen plotësisht funksionale më qëllim që të ndihmojnë bashkëpunimin ndërmjet Shërbimit Policor dhe autoriteteve komunale/udhëheqësve lokal të komunitetit. Kryetarët e Komunave duhet të kryesojnë Këshillat;*
- *Shëfat e policisë lokale duhet të zgjidhen sipas një procesi bashkëpunues ndërmjet Kuvendeve Komunale dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Kuvendi Komunal pas konsultave me Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të propozojë së paku dy emra për pozitën e shëfit të stacionit të policisë lokale të cilët plotësojnë të gjitha kërkesat minimale profesionale të përcaktuara sipas legjislacionit të Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme pastaj mund të emërojë një kandidat nga kjo listë brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga momenti i pranimit të listës. Në rast se ministria dështon të pranohet njërin prej kandidatëve brenda 15 ditësh që nga momenti i pranimit të listës, atëherë Kuvendi Komunal duhet të propozojë listën e dytë e cila duhet të përmbajë të gjithë kandidatët nga lista e parë dhe dy kandidatë të rinj të cilët vinë nga personeli ekzistues i Shërbimit Policor të Kosovës të cilët i plotësojnë të gjitha kërkesat minimale profesionale të përcaktuara me ligjet e Kosovës. Ministria pastaj është e obliguar që të emërojë njërin nga kandidatët e listës së dytë brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga momenti i pranimit të kësaj liste;*
- *Si rregull e përgjithshme, shëfat e policisë lokale duhet të informohen paraprakisht për operacionet që mund të ndërmerren nga forcat policore të nivelit qendror apo ato speciale brenda perimetrit të stacionit të policisë lokale përveç në rastet kur operacionet e tilla kërkojnë një qasje tjetër;*
- *Për aq sa është e mundur, Kufijtë e Stacionit Policor të distriktit duhet të përputhen me kufijtë komunal (UNOSEK, shtator. 2006).*

Sfidat kryesore që priten të shfaqen më fillimin e procesit të implementimit duket se do të jenë ato që kanë të bëjnë me emërimin e shëfave të policisë lokale dhe ruajtjen e zinxhirit komandues të unifikuar të SHPK-së në gjithë Kosovën. Deri në këtë fazë nuk ka një qartësi

**Decentralizimi do ti mundësoj policisë lokale që të përkujdeset për rëndin dhe ligjin në komuna**

të mjaftueshme lidhur me procesin e saktë të përzgjedhjes së shëfave të policisë lokale. Përveç kësaj edhe akterët të cilët priten ta bëjnë implementimin e këtyre dispozitave të veçanta në përgjithësi nuk janë në dijeni se si do rrjedh ky proces. Me qëllim që të shmangen konfrontimet gjatë procesit të implementimit të propozimit përfundimtar të dokumentit të UNOSEK-ut, kërkohet të ketë shumë më tepër transparencë dhe sqarime në raport me akterët e përfshirë, MPB-në, MD-në dhe të gjitha pushtetet komunale lidhur me detajet e të gjitha dispozitave relevante. Duke mos i përfshirë në mënyrë përmbajtjesore akterët kryesorë të cilët do jenë përgjegjës për implementimin e këtyre dispozitave në fushën e policisë dhe gjyqësisë, Ekipi i Unitetit vetëm sa e ka shtuar paqartësinë (dhe si rrjedhojë mund të krijohet tension në të ardhmen) brenda IPVQ-ve dhe udhëheqësve komunal duke e rrezikuar kështu suksesin e procesit të implementimit. Duhet marrë në konsideratë faktin se serbët e Kosovës i qasen çështjes së policisë lokale dhe gjyqësisë kryesisht nga këndvështrimi i tyre lidhur me pakënaqësinë me këto shërbime dhe nevojën për të pasur një përfshirje me të fuqishme në vendim-marrje. Në anën tjetër, institucionet e Kosovës duket se nuk janë të

gatshme për ndryshime përmbajtjesore në këtë fushë përveç atyre që besohet se do të përmirësonin shërbimet e caktuara publike.

Njëri ndër skenarët më të mundshëm të ndodhë në të ardhmen është ai në të cilin kuvendet komunale do të insistojnë fuqimisht që të emërojnë shefat e policisë lokale të cilët janë lojal ndaj kryetarit të komunës, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) do të përpiqet të emëroj një kandidat tjetër profesional apo lojal. Kjo konkurrencë ndërmjet kuvendeve komunale dhe MPB-së lidhur me zgjedhjen e shefave të policisë lokale mund të bëhet burim i pashtershëm i tensioneve dhe konflikteve. Prandaj kjo çështje duhet të qartësohet më qëllim të shmangies së tensioneve të panevojshme të cilat mund të rezultojnë në konflikte më vonë. Ata të cilët duhet të rregullojnë çështjen e zgjedhjes së shefave të policisë lokale duhet ta kenë parasysh se çfarëdo rregulli që parashikohet të aplikohet për komunat me shumicë serbe në Kosovë, e njëjta rregull duhet vlej edhe për komunat tjera në tërë Kosovën. Për më tepër, asnjë mekanizëm legal nuk mund të siguroj zgjidhje për problemet politike dhe praktike që mund të shfaqen, andaj edhe shtrohet nevoja për krijimin e kanaleve komunikuese të qëndrueshme të cilat do shërbejnë për trajtimin e këtyre problemeve kur ato të shfaqen.

Në fushën e policisë duket se ekziston një tregues i cili mund të përdoret si mekanizëm kryesor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në aspektin e decentralizimit në përgjithësi. Sipas dokumenteve që kanë qarkulluar ndërmjet UNOSEK-ut dhe palëve, “gjatë gjithë prezencës ndërkombëtare rastet e tilla të mosmarrëveshjeve do të jenë subjekt i trajtimit nga ana prezencës ndërkombëtare për marrjen e vendimit përfundimtar” (UNOSEK, shtator 2006). Delegacioni i Kosovës fillimisht iu është kundërvënë një ideje të tillë, por më vonë është tërhequr nga pozicioni i tij. Me aplikimin e një zgjidhje të tillë lidhur me mosmarrëveshjet në decentralizim, institucionet qendrore të Kosovës janë vetëm njëra nga tri palët duke i lënë fjalën e fundit prezencës së ardhshme ndërkombëtare.

Duke lenë anash konfliktet e mundshme lidhur me çështjen e emërimit, kërcënimi kryesor që lidhet me policinë është mosnjohja e zinxhirit komandues. Si një burim i izoluar i tensionit ky skenar ka relativisht pak gjasa të dalë në sipërfaqe. Por në rast të ndarjes së pjesës veriore dhe/apo shpalljes së autonomisë territoriale nga serbet, atëherë ai do të pasonte automatikisht. Gjithashtu, është çështje kritike nëse policia do sfidonte zinxhirin komandues edhe në rast se gjykatat do të funksiononin si pjesë e sistemit uniform dhe pa ndonjë tension serioz etnik.

**Një ndarje jo e qartë ndërmjet përgjegjësive ekskluzive dhe të përbashkëta do të sjell vështirësi kur komunat nuk do të mund të realizojnë përgjegjësit dhe projektet e tyre.**

Probleme të ngjashme me ato të policisë ekzistojnë edhe në sektorin e gjyqësisë. Dokumenti punues i UNOSEK-ut nuk specifikon përgjegjësitë e qeverisë lokale në fushën e gjyqësisë. Përderisa zyrtarët e qeverisë së Kosovës konsiderojnë se gjyqësia duhet të jetë e pavarur nga çfarëdo ndërhyrje apo ndikim nga institucionet tjera, serbët e Kosovës do dëshironin që institucionet komunale të kenë ndikim në këtë fushë për shkak të mungesës së besimit që kanë. Sipas qëndrimeve të shprehura nga serbët e Kosovës kërkohet kohë për të ndërtuar besimit dhe pas një periudhe të caktuar, gjyqet shumë-etnike do të mund të jenë një zgjidhje e mirë (për shembull, përvoja në Shtërpcë). Dokumenti i propozuar për decentralizim pranon faktin se serbet e Kosovës duhet përfshihen më shumë në fushën e gjyqësisë. Sipas dokumentit të propozuar:



- (a) *Institucionet juridike të Kosovës për aq sa është e mundur duhet të pasqyrojnë përbërjen etnike brenda zonës së tyre të juridiksionit.*
- (b) *Me qëllim që të sigurohet qasje e barabartë në gjyqësi në rastet e veprave kriminale dhe civile, do të aplikohen dispozita të veçanta për ti bërë pozitat e gjykatësve dhe prokurorëve të hapura për të gjitha komunitetet dhe aty ku është e mundshme të sigurohet që gjykatësit/prokurorët janë pjesëtarë të komunitetit shumicë (Zyrat e Ndërlidhëse të Gjykatave, gjatë ditëve të punë etj.)*
- (c) *Komunitetet pakicë do të kenë ndikim në zgjedhjen e gjyqtarëve/prokurorëve për gjykata në komunat me shumicë serbe si në Gjykatën e Qarkut e po ashtu edhe në Gjykatën Komunale. Modalitetet për të arritur një gjë të tillë duhet të trajtoben brenda kontekstit të masave mbrojtëse për komunitete, mundësisht përmes mekanizmave speciale të cilët përfshijnë Këshillat e Gjyqësisë dhe Prokurorisë së Kosovës dhe anëtarët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëset që përfaqësojnë komunitetet (UNOSEK, shtator. 2006).*

Sa i përket sistemit të drejtësisë dhe gjykatave ekziston një vlerësim i përbashkët tek shqiptarët e Kosovës se sistemi i drejtësisë dhe gjykatat në veçanti duhet të jenë të pavarura në kryerjen e detyrave të tyre. Edhe pse pakoja dhe elementet tjera të saj janë të paqarta ende, zyrtarët nga Ministria e Drejtësisë presin që çështja e gjyqësisë të trajtohet si një lëmi e pavarur. Sipas pikëpamjes së tyre, do të ketë probleme serioze në rast se gjyqtarët do të emërohen nga të tjerët (dhe nëse komunat do të kenë ndikim në një proces të tillë). Në parim, edhe serbet janë të pirur ti nënshtrohen një parimi të tillë por ata i frikësohen faktit që shqiptarët ti emërojnë gjyqtarët e tyre. Në mungesë të një institucioni qendror të përbashkët me shqiptarët, nuk ka një mekanizëm tjetër për të siguruar se ata do t'i emërojnë gjyqtarët, përveç që ta bartin një gjë të tillë në kuvende. Nga kjo del se pavarësisht zgjidhjes që do aplikohet, lufta ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale me shumicë serbe do të jetë përreth asaj se kush do të përcaktoj kriteret për emërimin e gjyqtarëve dhe kush do të ketë ndikim në emërimin e tyre.

“Sa i përket gjyqësorit nuk mund të ketë decentralizim ndërsa zyrat ndërlidhëse të gjykatave në zonat e banuara nga serbët janë treguar si të suksesshme dhe ato e kanë zvogëluar rolin e strukturave paralele” ka pohuar ministri i drejtësisë (Salihaj, 2006). Sido që të jetë, duke e pranuar faktin se gjyqësia duhet të jetë e pavarur, shqiptarët e Kosovës pajtohen se është shumë e rëndësishme që serbët e Kosovës (gjyqtarët dhe prokurorët serbë) të përfshihen në sistemin e drejtësisë dhe kështu ti epet fund funksionimit të strukturave paralele (Haziri, 2006). Balancimi i rolit të Këshillit gjyqësor (për emërimin e gjyqtarëve) dhe Ministrisë së Drejtësisë (për emërimin e prokurorëve) me pretendimet për përfshirjen e mundshme të komunave me shumicë serbe, do të jetë një gjë shumë sfiduese edhe sikur të ekzistonin ligje të qarta në përdorim.

Kërcënimi më serioz mund të shfaqet në rast se ndonjë gjyqtarë në ndonjë nga komunat me shumicë serbe nuk i pranon vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese në rastet kur organet gjyqësore qendrore i anulojnë vendimet e gjykatave më të ulëta. Si një rast i izoluar ky skenar ka gjasa të vogla të shfaqet mirëpo në rast të ndarjes së pjesës veriore, shpalljes së autonomisë territoriale apo mosrespektimit të zinxhirit komandues në fushën e policisë, atëherë do të mund të shpërthente menjëherë.

### e. Financimi/ donacionet nga Beogradi

Kur fillimisht u propozua financimi nga Beogradi për komunat me shumicë serbe nga ana e delegacionit serbë, kjo çështje u konsiderua si problematike. Me kalimin e kohës, delegacioni i Kosovës e pranoi një gjë të tillë me kusht që të ketë transparencë rreth këtyre donacioneve. Zyrtarët e qeverisë së Kosovës insistojnë se çfarëdo donacioni i tillë që vjen nga Beogradi

**“Financimi nga Beogradi nuk është problem i madh...ai i cili jep paratë gjithashtu i menaxhon ato”**

duhet të kaloj nëpërmes Thesarit të Kosovës (brenda ministrisë së financave dhe ekonomisë) me qëllim që të shmanget ndonjë keqpërdorim i mundshëm (Haziri 2006). UNOSEK-u e ka parashikua një gjë të tillë si në vijim: a) Beogradi mund të siguroj donacione financiare me kusht që ato të bëhen në mënyrë transparente, përmes Thesarit të Kosovës, dhe të jenë të kufizuara brenda kompetencave të caktuara komunale, duke përfshirë edhe opsionin e llogarive bankare në bankat komerciale të pranuar nga Thesari Qendror; b) këto donacione duhet të përputhen bashkë me shpenzimet relevante në buxhetin e komunave përkatëse e të cilat duhet të bëhen publike; c) donacionet financiare nga Beogradi nuk do të ndikojnë në ndarjen e ndihmave financiare të përcaktuara për komuna sipas formulës për grante të Kosovës; d) shpenzimet tjera duke përfshirë edhe pagesat për fazat përgatitore të projekteve do të jenë të pranueshme për donacione të tilla; e) qeveria qendrore e Kosovës duhet të sigurojë që financimi nga Beogradi të ketë një trajtim special, duke përfshirë edhe përjashtimin nga pagesa e taksave (UNOSEK, shtator 2006).

Shqiptarët e Kosovës vazhdojnë ta shikojnë më mosbesim çështjen e donacioneve nga Beogradi dhe menaxhimin e këtyre fondeve nga komunat me shumicë serbe përkundër faktit se qëndrimet e tyre kanë evoluuar në kuadër të zhvillimit të negociatave në Vjenë. Sipas pikëpamjes së tyre, kjo çështje duhet të rregullohet dhe të mbahet nën një kontroll të rreptë (Mujota 2006). Sipas Ramush Tahirit<sup>14</sup>, çështja e financimit/fondeve nga Beogradi është pjesa më e lehtë për implementim në aspektin praktik (Tahiri 2006). Sipas tij, “financimi nga Beogradi nuk është problem i madh” duke argumentuar se, “ai që jep paratë i menaxhon ato gjithashtu”. Nga këndvështrimi i tij, qeveria e Kosovës duhet vetëm të informohet për të gjitha fondet që vinë brenda. Ndryshe nga që ishte në fillim të procesit të Vjenës, sot çështja e donacioneve nga Beogradi në përgjithësi konsiderohet si një e drejtë legjitime e serbëve të Kosovës për atë kohë sa do të ketë transparencë lidhur me përdorimin e tyre.

Në këtë fushë mund të flasim vetëm për problemet praktike të cilat mund të shfaqen në planin afat-shkurtër. Për momentin qeveria qendrore kontrollon edhe fondet komunale ndërsa financimi direkt për komunat me shumicë serbe do të kërkojë një trajtim të veçantë dhe rregulla të reja. Tensionet dhe kontestet për kompetenca ndërmjet MFE, komunave me shumicë serbe janë shumë të pritshme ndërsa mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pa ndërhyrjen e administratës ndërkombëtare janë të paktë.

**Nga perspektiva afatgjate, financimi i papenguar nga Beogradi do të rrezikoj zhvillimin e lojalitetit të serbëve të Kosovës kundrejt institucioneve të Kosovës.**

Nga perspektiva afatgjate, financimi i papenguar nga Beogradi do të rrezikoj zhvillimin e lojalitetit të serbëve të Kosovës kundrejt institucioneve të Kosovës. Në rastin më të keq një gjë e tillë mund të shpie drejt mosnjohjes së autoritetit të institucioneve të Kosovës. Sfidat në këtë fushë kryesisht shfaqet në mënyrën e lejimit të së drejtës për financim nga Beogradi,

<sup>14</sup> Z. Ramush Tahiri është këshilltar politik i ish- kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Nexhat Daci

ndërsa në të njëjtën kohë edhe në vënien e kufizimeve që kjo ndihmë të mos orientohet kundër ndërtimit të lojalitetit të serbëve të Kosovës ndaj Prishtinës.

### ***f. Arsimi dhe shëndetësia***

Arsimi dhe shëndetësia janë dy fusha tjera ku komunat e Kosovës e në veçanti komunat me shumicë serbe do të marrin përsipër më shumë kompetenca si rezultat i procesit të decentralizimit. Edhe pse këto dy fusha janë shumë të rëndësishme, duket si nuk iu është kushtuar shumë vëmendje. Kështu, përderisa në njërin anë, “serbët e Kosovës besojnë se institucionet e Kosovës duan që ta imponojnë sistemin arsimor dhe ta pengojnë zhvillimin e identitetit etnik” (Rikalo 2006), ndërsa në anën tjetër, shqiptarët e Kosovës argumentojnë se “integrimi i komunitetit serb në sistemin arsimor ka dështuar kryesisht për shkak të politikës së Beogradit” (Berisha 2006).

Pas përfundimit të luftës, serbët e Kosovës nuk kanë pasur qasje të mjaftueshme në institucionet publike në këto dy fusha. Për shkak të jetesës në enklavat e izoluar, ata

**“Serbët e Kosovës besojnë se institucionet e Kosovës duan që ta imponojnë sistemin arsimor dhe ta pengojnë zhvillimin e identitetit etnik”**

vazhdojnë të vijojnë mësimin në shkollat mono-etnike dhe gjithashtu përdorin shërbimet shëndetësore të ndara. Në shumicën e rasteve, për serbët e Kosovës kualiteti i këtyre shërbimeve të cilat bëhen nga strukturat paralele nuk është të kënaqshme dhe ato nuk kontrollohen nga ndonjë institucion relevant i Kosovës. Mjetet dhe pagat për të punësuarit në këto

dy fusha kryesisht sigurohen nga Serbia plus parave tjera të cilat ndahen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës (OSBE-ja, strukturat paralele në Kosovë, 2003). Shumica e përpjekje të bërë nga institucionet qendrore të Kosovës për ti integruar serbët e Kosovës në sistemit arsimor dhe shëndetësor deri më tani kanë qenë të pasuksesshme.

Derisa shqiptarët e Kosovës e kanë përkrahur idenë që “komunat mund të bashkëpunojnë në lëmin e shëndetësisë sekondare”, ata kanë kushtëzuar një veprimtari të tillë përmes domosdoshmërisë për bashkëpunim me ministrinë e shëndetësisë” (parimet e dokumentit). Delegacioni serb në anën tjetër ka insistuar që komunat me shumicë serbe dhe partneriteti i tyre, “në përputhshmëri me autonominë e plotë që e kanë” duhet të jenë përgjegjëse për shëndetësinë primare dhe sekondare. Sipas delegacionit serb, shëndetësia primare do të bëhej në kuadër të kompetencave të komunave ndërsa ajo sekondare në kuadër të partneritetit të komunave (UNOSEK, shtator 2006).

Çështja e sektorit të shëndetësisë ndoshta është edhe më tepër e ndjeshme për shkak të mungesës së besimit të serbëve të Kosovës tek mjekët shqiptarë (Rikalo 2006). Për shkak të këtij mosbesimi serbët e Kosovës e konsiderojnë si një çështje thelbësore që të mbështeten në shërbimet që iu ofrohen nga shërbimi i tyre sekondar shëndetësor. Sipas një numri të konsiderueshëm të pjesëtarëve të komunitetit shqiptarë dhe atij serb, besohet se vetëm pas një dekadë apo më shumë, besimi ndërmjet komuniteteve do të mund të rivendoset duke e bërë të mundur zbatimin e një sistemi arsimor unik.

**Shqiptarët e Kosovës pohojnë se “integrimi i komunitetit serb në sistemin arsimor ka dështuar kryesisht për shkak të politikës së Beogradit”**

Ndryshe nga fushat tjera, sa i përket kujdesit shëndetësor është paraparë një mekanizëm koordinues i veçantë i cili më siguri që do të shërbej si një lloj forumi për zgjedhjen e

mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve të ndryshme. Një mekanizëm koordinues do të vendoset ndërmjet ministrisë së shëndetësisë dhe komunave. Ky mekanizëm do të ketë përgjegjësi për kujdesin shëndetësor sekondar edhe pse një numër i madh i çështjeve që ndërlihdën në këtë aspekt ende mbeten të paqarta (UNOSEK, shtator 2006, pika 8(d)). Megjithatë, ideja për krijimin e një mekanizmi të tillë koordinues është neutralizuar për shkak të propozimit të serbëve për të formuar një organ të veçantë brenda komunave me shumicë serbe. Ata [serbët] kanë insistuar se, “komunat me shumicë serbe do të krijojnë një organ adekuat i cili do të përbëhet nga të gjithë hisedarët (ata që sigurojnë shërbimet, përfituesit dhe përfaqësuesit e qeverive komunale) të cilët do të jenë përgjegjës për udhëheqje, planifikim, organizim të shërbimeve shëndetësore, monitorim dhe kontroll.” (UNOSEK, shtator 2006). Ky organ do të jetë përgjegjës për licencimin e institucioneve private shëndetësore në zonat e banuara me serbe. Përderisa këto përgjegjësi aktualisht ushtrohen në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe autoritetet lokale, zgjidhja e propozuar nënkupton eliminimin nga skema të autoriteteve qendrore edhe kur është në pyetje monitorimi. Ekziston edhe një problem tjetër që lidhet me këtë “organ për përpilimin e standardeve” që pritet të themelohet nga komunat me shumicë serbe. Mbetet ende e paqartë se në çfarë mënyrë ky organ do të ndikoj në kompetencat e ministrisë për ti përgatitur politikat, strategjitë dhe legjislacionin, pasi që ajo çfarë duket si synim i këtij organi midis tjerash është edhe synimi për të ushtruar përgjegjësi që aktualisht janë kompetencë e ministrisë.

Me qëllim që të përmirësohet situata e tanishme, komuniteti ndërkombëtar në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se rritja e kompetencave të komunave e cila do të ndodhë përmes decentralizimit do të jetë një përfitim i veçantë për serbët e Kosovës. Sipas PSPP-së, Joachim Ruecker, do të ketë një rritje shtesë të kompetencave për komunat me shumicë serbe në krahasim me ato ku shqiptarët janë shumicë. Këto kompetenca përfshijnë arsimin, plan-programet dhe shëndetësinë “ në një nivel më të lartë sesa në ato [komuna] të dominuara nga shqiptarët” (Zëri, 8.12.2006). Sipas Ruecker, “pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, komunat në veri të Kosovës do të kenë kompetenca asimetrike” (Koha Ditore 8.12.2006). Përderisa

**Përderisa për komunat me shumicë shqiptare kompetencat regjionale siç është kujdesi shëndetësor sekondar do të mbesin të centralizuara, ato do të decentralizohen në veri të Mitrovicës dhe në Graçanicë.**

këto deklarata ndoshta kanë qetësuar një numër të konsiderueshëm të serbëve duke iu dhënë shpresë atyre se vuajtjet e tyre do pakësohen, këto deklarata gjithashtu kanë shtuar frikën në mesin e shqiptarëve të Kosovës për pasojat që do sjell decentralizimi.

Kujdesi shëndetësor primar si një përgjegjësi që tashmë ushtrohet nga komunat nuk pritet të sjell vështirësi në implementim. Një fushë më problematike mund të jenë dispozitat për kujdesin shëndetësor sekondar në komunat me shumicë serbe, varësisht nga numri i objekteve të kujdesit shëndetësor sekondar të cilat pritet të themelohen, niveli i njësisive të vetë-qeverisjes lokale në të cilat këto shërbime do të themelohen në relacion me ministrinë e shëndetësisë. Së paku për Mitrovicën, është e qartë se përgjegjësitë për kujdesin shëndetësor sekondar do jenë kompetencë e entiteteve jo qendrore.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e (ri)organizimit të sistemit të arsimit dhe kujdesit shëndetësor brenda një ombrelle të vetme, delegacioni i Kosovës është pajtuar në disa dispozita në kuadër të pakos për decentralizim të cilat do t’iu adresohen këtyre dy fushave më qëllim të përmirësimit të gjendjes së serbëve të Kosovës. Sipas propozimit, komunat e

Kosovës do të jenë kompetente për arsimin në nivelin primar dhe sekondar ndërsa Mitrovica veriore do të jetë e vetmja komunë që do të jetë kompetente për universitetin në gjuhën serbë (UNOSEK shtator 2006, pika 9(j)). Përderisa të gjitha komunat e Kosovës janë kompetente për kujdesin shëndetësor primar, disa komuna me shumicë serbe (Mitrovica Veriore, Graçanica dhe Shtërpçë) do të kenë një rritje të kompetencave duke përfshirë edhe ato për kujdesin shëndetësor sekondar (UNOSEK shtator 2006, pika 8(a)). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e po ashtu edhe Ministria e Shëndetësisë pretendojnë se do të jenë përgjegjëse për të monitoruar përputhshmërinë me kornizën legjislative të Kosovës brenda fushave të tyre përkatëse. Përkundër kësaj, mbetet të shihet se çfarë kompetencash specifike do të mbesin në kuadër të ministrive, dhe ndërmjet tjerash, të shihet se si do veprohet në rastet kur komunat do të bien ndesh me kornizën legjislative të Kosovës gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre.

Idetë e përbashkëta të cilat pritet se do të dalin nga UNOSEK-u duket se do të jenë ato të cilat do mundësojnë që kompetencat qendrore të mbesin në qendër mirëpo me një mbikëqyrje të theksuar ndërkombëtare. Megjithatë, kompetencat regjionale si në fushën e kujdesit shëndetësor sekondar, përderisa do të jenë centralizuara për komunat me shumicë shqiptare, ato do të decentralizohen në Mitrovicën veriore dhe në Graçanicë në kuadër të komunave tjera përreth, ku e para do mbuloj tri komuna tjera në veri ndërsa e dyta do jetë kompetente për pjesën tjetër të serbëve që jetojnë në jug të lumit Ibër. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me arsimin e lartë i cili do të menaxhohet nga Mitrovica veriore edhe pse nga ana akademike, universiteti duhet të udhëhiqet nga një organ i pavarur.

Për këto dy zgjidhje nuk pritet të ketë ndonjë problem të madh përveç numrit të personelit. Universiteti në veri tashmë pothuaj ka shumë më tepër studentë krahasuar me përqindjen e serbëve që jetojnë në Kosovë dhe MASHT-i mbase nuk do të tregoj vullnet për të paguar për të gjithë ata. Reformat do të nënkuptonin një administratë më të fokusuar dhe numër më të vogël të personelit në arsim dhe shëndetësi. Përderisa institucionet e Kosovës pak a shumë kanë arritur në përputhshmëri me udhëzimet e FMN-së, institucionet serbe kanë vazhduar të kenë tepëri të stafit e cila e ka zanafillën që nga koha e paraluftës. Për shembull, sipas një kalkulimi të bërë nga KIPRED-i bazuar në të dhënat nga terreni, në komunën e Novo Bërdos ka 12 herë më shumë infermiere në 1,000 banorë sesa në Prizren. Sigurisht që qeveria e Kosovës nuk do të dëshironte të paguante për një gjë të tillë.

Kërcënimi kryesor do të jetë në rast se kontrolli i Beogradit në fushën e arsimit në komunat me shumicë serbe nuk bartet tek institucionet qendrore të Kosovës. Çështjet praktike, siç është emërimi i rektorit të universitetit në veri të Mitrovicës mund të shkaktojnë tension ndërmjet institucioneve qendrore të Kosovës dhe komunitetit serb në Kosovë. Ky burim i konfliktit mund të fitoj peshë të madhe vetëm në rast të mos-ndarjes së Mitrovicë dhe në rast të mos-deklarimit të autonomisë politiko-territoriale nga serbët.

### **g. Energjia**

Energjia është një nga çështjet dytësore e cila nuk ka ndonjë lidhje direkte me procesin e decentralizimit dhe çështjes së furnizimit me energji nuk iu është kushtuar shumë vëmendje nga Ekipi i Unitetit (EiU). Autoriteti relevant, Ministria e Energjisë dhe Minerave (MEM) nuk është e kujdesshme në raport me enklavat. Sipas MEM-it ligjet dhe rregulloret e UNMIK-ut të cilat e aktualisht e rregullojnë këtë fushë janë të pranueshme dhe e bëjnë punën funksionale (Dida 2006). Në kërkim të ndonjë zgjidhje për ta përmirësuar gjendjen e

rëndë energjetike, qeveria e Serbisë ka ofruar furnizim me energji për enklavat serbe në Kosovë të cilat nuk e paguajnë energjinë elektrike të shpenzuar. Qeveria e Kosovës ka refuzuar ofertën për furnizim me energji të bërë nga qeveria e Serbisë duke e konsideruar atë si një veprim politik (Lajm 2.11.2006). UNMIK-u në anën tjetër është treguar më i hapur. Përkundër kësaj, Agron Dida, zëvendës ministër i MEM-it, beson se UNMIK-u nuk do të lejoj trajtime të përzgjedhura vetëm për serbet duke e pranuar atë ofertë (Dida 2006). Përfaqësuesit e UNMIK-it kanë thënë publikisht se konsultimet ndërmjet UNMIK-it dhe QKSKM serbe janë duke vazhduar deri në marrjen e një vendimi (deklaratë për shtyp e UNMIK-it, 6.12.2006; Lajm, 7.12.2006, f. 7). Sipas Didës, ministria është më tepër e interesuar për rritjen e furnizimit me energji dhe konsideron se “rivendosja” e pagesave nëpër enklava është një çështje e “vogël” me të cilën do të merremi më vonë (Dida 2006). KEK-u nga e saj ka deklaruar se ata janë konsultuar nga institucionet relevante të Kosovës vetëm lidhur efektet e mundshme teknike dhe komerciale që do të kishte për KEK-un furnizimi me energji elektrike për enklavat serbe në Kosovë. Sipas UNMIK-it, çështja e ofertës së Serbisë duhet lenë jashtë kontekstit politik dhe thjesht duhet të kuptohet si një çështje teknike dhe komerciale (Express, 8.12.2006). Furnizimi me energji elektrike për serbet nga Serbia është një çështje faktike bazuar në një marrëveshje ndërmjet UNMIK-it dhe Beogradit. Duke u bazuar me një fat të tillë, institucioneve të Kosovës nuk iu mbetet gjë tjetër përveçse ti kundërvihen verbalisht një gjëje të tillë në pamundësi ta parandalojnë atë. Një mundësi tjetër që ata mund të bëjnë është që ta zbusin fjalorin e tyre dhe taktikisht të pajtohen heshturazi për diçka për të cilën ata imtimisht do të dëshironin që të dështonte.

Sado specifike dhe teknike të mund të jenë zgjidhjet për implementim (për shembull, furnizimi me energji i enklavave serbe të Kosovës), duke lënë anash bisedimeve ministrinë kompetente (në këtë rast MEM) do të krijohet një hapësirë e re për vazhdimin e mosmarrëveshjeve rreth kompetencave.

Si një kërcënim, dhe kështu edhe burim tensioni, në këtë fushë fillimisht do të jetë vazhdimësia e serbëve për mospagesën e energjisë elektrike dhe kjo gjë do të konsiderohet nga institucionet e Kosovës si një sfidë e drejtpërdrejtë ndaj autoritetit të këtyre institucioneve, ndërsa nga pjesa shumicë e komunitetit kjo do të konsiderohet si një privilegj i padrejtë që bëhet nga institucionet e Kosovës, (b) Serbia vetëm do të insistoj që ta përdor rrjetin për t’iu shpërndarë energji serbëve lokal por do të refuzoj që KEK-u apo MEM të këtë ndonjë rol më të madh. Serbia duhet të insistoj që serbet të paguajnë faturat e energjisë dhe t’iu sqaroj atyre se gradualisht ata do të jenë pjesë e sistemit të gjerë shpërndarës së Kosovës. Në të njëjtën kohë duhet të zhvillohen plane se si të shmanget varësia na ndihma e Serbisë në planin afatgjatë. Problemi kryesor prapëseprapë është i ndërlidhur lidhur me kontrollin fizik mbi burimet (minierat e thëngjillit, pjesë të rrjetit elektrik, stabilimenteve energjetike dhe tjera të ndërlidhura). Kontrolli i ndonjë pjesë të këtyre burimeve do të mund të përdorej si mjet për ti shantazhuar institucionet qendrore.

**Problemi kryesor është i ndërlidhur lidhur me kontrollin fizik mbi burimet. Kontrolli i ndonjë pjesë të këtyre burimeve do të mund të përdorej si mjet për ti shantazhuar institucionet qendrore**

#### ***h. Telekomunikacioni***

Përkundër faktit se nuk është trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në bisedimet e Vjenës, telekomunikimi është një çështje tjetër në të cilën komuniteti serb aspiron që të këtë kontroll sa më shumë që është e mundur. Aktualisht, Kosova ka një numër të caktuar të operatorëve

ilegal. Të njëjtët konsiderohen si vital për serbët kryesisht për shkak se ofrojnë mundësi të kontakteve të lira dhe të përballueshme ndërmjet tyre dhe me Serbinë.

Vetëm rishtazi autoritetet kompetente, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit ART) ka filluar që fjalët ti shoqëroj me veprime konkrete në kuadër të një përpjekje për ti dhënë fund operatorëve ilegal. Që nga 8 nëntori, ART-ja ka çmontuar antenat e operatorëve ilegal serb në Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Prizren duke i lënë të paprekura enklavat serbe në të cilat telefonitë mobile vazhdojnë të operojnë (Epoka e Re, 10.11.2006). Kjo ka ndodhur për shkak të kërkesës së UNMIK-ut bërë ART-ës për të mos i çmontuar antenat ilegale në enklava për shkak të situatës së brishtë politike në Kosovë (Koha Ditore 27.9.2006, f. 42). Ndërsa ART-ja ka argumentuar se është detyrë e policisë lokale që ti çmontoj antenat, autoritetet vendore kanë vazhduar që ti injorojnë kërkesat e qytetarëve për ndërprerjen e punës së operatorëve ilegal duke i akuzuar ata se “këto çështje janë kompetencë e ART-së” (po aty). Sipas ART-së inspektorët komunal mund të tregohen si shumë të rëndësishëm në implementimin e rregullave të reja që do rrjedhin nga plani i decentralizimit sepse ata do të kenë një rol shumë të madh në procesin e licencimit të ndërtimit të çfarëdo lloj objektesh (Berisha, 2006). Zyrtarët e ART-së njësoj sikur ata të MEM-it pajtohen se kompetencat e nivelit qendror dhe atij lokal duhet të qartësohen qartë në kuadër të pakos, me qëllim që të mundësohet që këto institucione të funksionojnë në mënyrë korrekte (Berisha, 2006). Përderisa serbët e konsiderojnë heqjen e antenave të operatorëve ilegal si një sulm të drejtuar kundër tyre, ata do të vazhdojnë që ti kundërvihen veprimeve të tilla dhe të kërkojnë modalitete të cilat do t’iu garantonin atyre përdorimin e shërbimeve të njëjta. Kështu, serbët do të dëshironin që të kenë në duart e tyre sa më shumë kompetenca në fushën e telekomunikacionit, ndërsa ART-ja në anën tjetër i kundërvihet fuqimisht çfarëdo mundësie të delegimit të autoritetit të tij tek autoritetet komunale (Berisha 2006).

Shpejt mund të pritet që institucionet e Kosovës të aplikojnë për marrjen e kodit të ri telefonik, ndërsa serbët mund të hezitojnë që të heqin dorë nga mundësia që kanë pasur deri më tani, ku thirrjet e tyre në Serbi janë trajtuar si thirrje lokale. Kështu, përderisa pozicioni i kosovarëve është që të mos këtë bartje të kompetencave në nivelet komunale, serbët do të preferojnë që të kenë (a) thirrje të lira dhe lokale me Serbinë dhe (b) ata [Beogradi] në mënyrë të veçantë do të dëshironte që operatori jugosllav të konsiderohet si pjesë e sovranitetit jugosllav. Përderisa kjo e dyta është e pamundur në statusin e ardhshëm, e para është një çështje e cila duhet marrë në konsideratë dhe ajo ose do të ndodhet në propozimin e Ahtisaar-it por në rast se jo, atëherë përsëri do të rishfaqet si problem pas 3 viteve në vijim kur Zyra Civil Ndërkombëtare do bëjë përpjekje për ti bindur serbët që ta respektojnë autoritetin e Prishtinës.

## **5. PËRFUNDIMET**

Përderisa pakoja për decentralizimin pritet të bëhet publike shumë shpejt, ndjenjat e përgjithshme janë të përziera ndërsa përkushtimi i institucioneve është disi i kushtëzuar. Kjo e fundit do të vihet edhe më tepër në pikëpyetje në rast se nuk do të ketë qartësi rreth statusit të ardhshëm ashtu siç edhe pritet.

Ekzistojnë kërcënime të konsiderueshme lidhur me perceptimet për decentralizimin si të tillë. Si shqiptarët e Kosovës e gjithashtu edhe serbët e Kosovës e shohin decentralizimin përmes thjerrëzave të ndryshme dhe kanë pritje të ndryshme nga ky proces. Decentralizimi vazhdon të mbetet i politizuar së tepërmi dhe nuk është bërë sa duhet për të sqaruar

substancën e decentralizimit, procesin në tërësi, rezultatet e pritura dhe kornizën kohore të tij.

Sa më e madhe të jetë qartësia e pakos së decentralizimit ajo do të ndihmonte në uljen e tensioneve të mundshme. Megjithëkëtë, asnjë mekanizëm ligjor nuk do të mund të siguroj zgjidhje për të gjitha problemet politike dhe praktike; prandaj do të duhej të krijoheshin kanale të qëndrueshme të komunikimit për të zgjidhur problemet të cilat do të mund të shfaqen.

Ekzistojnë një numër serioz i kërcënimeve për sigurinë në Kosovë/ sigurinë e përgjithshme të cilat duhet pasur në konsideratë. Një burim potencial i kërcënimit lidhet me kufijtë e rinj të komunave të reja që do ndodhë si rezultat i decentralizimit. Në disa raste, udhëheqësit lokal të cilët do të “humbin” pjesë të territoreve për shkak të komunave të reja në mënyrë të hapur kanë shfaqur qëndrimin e tyre se ata nuk do të pranojnë kufijtë e rinj. Në aspektin praktik kjo do të nënkuptonte një mobilizim nga e udhëheqëseve të këtyre komunave për të ushtruar autoritetin e tyre në territorin i cili nuk do të jetë edhe më tutje legalisht brenda kufirit të pushtetit të tyre.

Një kërcënim tjetër do të jetë ndarja e qytetit të Mitrovicës. Në rast se gjendja e tanishme faktike e ndarjes forcohet më shumë, kjo do të vazhdonte të mbetej si një burim konstant i jostabilitetit për tërë Kosovën. Zgjatja e ndarjes së tanishme do të nënkuptonte vazhdimësinë e strukturave serbe, një sfidë të drejtpërdrejtë ndaj autoriteteve qendrore dhe një ndarje të thellë etnike.

Një tjetër burim i tensionit do të ishte shpallja e autonomisë politike dhe territoriale nga ana e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Gjatë procesit të negociatave përmes disa komenteve në dokumentin e Ahtisaari-it, delegacioni serb në mënyrë të vazhdueshme iu është referuar autonomisë. Brenda kontekstit të së drejtës së komunave me shumicë serbe për bashkëpunim të ndërsjellë dhe krijim të asociacioneve, kërcënimi më serioz do të ishte në rast se ato asociacione në mënyrë unilaterale do të transformoheshin në autonomi territoriale.

Kur janë në pyetje përgjegjësitë e reja të cilat do t’iu open komunave me shumicë serbe, pritet që të ketë tensione lidhur me emërimin e shefave të policisë lokale. Skenari më i rrezikshëm është në rast të mos respektimit të zinxhirit komandues. Si një burim i izoluar i tensionit ky skenar ka pak mundësi të shpërthej në sipërfaqe. Mirëpo, ai do të shpërthente automatikisht në rast të ndarjes së pjesës veriore/ dhe deklarimit të autonomisë territoriale.

Sa i përket drejtësisë, kërcënimi më serioz i cili mund të shfaqet do të ishte në rast se gjyqtarët në komunat me shumicë serbe nuk do të pranonin vendimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në ato raste kur organet qendrore gjyqësore do të anulonin vendimet e gjykatave më të ulëta. Si një mundësi e izoluar ky skenar ka pak mundësi të shfaqet, mirëpo ai do të mund të shfaqet automatikisht në rast të ndarjes së pjesës veriore, deklaratës për autonomi territoriale apo mos respektimit të zinxhirit komandues në fushën e policisë.

Financimi nga Beogradi nuk konsiderohet të jetë problem serioz në planin afat shkurtër. Megjithëkëtë, nga pikëpamja afat-gjate, financimi i papenguar nga Beogradi do të krijonte një barrierë serioze për zhvillimin e lojalitetit të serbëve të Kosovës ndaj Kosovës. Sfida kryesore në këtë fushë paraqitet në kuadër të së drejtës për financim nga Beogradi, ndërsa në të



njëjtën kohë pengimin e tendencave që kjo të përdoret si një mekanizëm që do të pengonte zhvillimin e lojalitetit të serbëve të Kosovës në raport me Prishtinën.

Një kërcënim serioz lidhur me arsimin në rast se kontrolli i Beogradit mbi fushën e arsimit në komunat me shumicë serbe nuk bartet tek institucionet qendrore të Kosovës. Çështjet praktike, për shembull, emërimi i rektorit të universitetit të Mitrovicës mund të shkaktoj tensione ndërmjet institucioneve qendrore të Kosovës dhe komunitetit serb të Kosovës. Ky burim i konfliktit mund të fitoj peshë serioze si i tillë vetëm në rast të mos-ndarjes së Mitrovicës dhe në rast se komunat me shumicë serbe nuk shpallin autonomi politiko-territoriale.

## Bibliografia

- Bajraktari, Yll dhe Christina Parajon. “Nuk Kosovë të qëndrueshme pa zgjidhjen për Mitrovicën”,  
Instituti për paqe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,  
[http://www.usip.org/pubs/usipeace\\_briefings/2006/0724\\_mitrovica.html#mitrovica](http://www.usip.org/pubs/usipeace_briefings/2006/0724_mitrovica.html#mitrovica),  
(qasur me 17 nëntor 2006)
- Danas. Decentralizimi i Kosovës,  
<http://www.danas.co.yu/20040322/hronika2.html#0>,
- Desku, Arlinda. 2006. Puthja e madhe. “Express”, 4 maj.
- Desku, Bujar. 2006. Refuzimi i energjisë nga Serbia. Lajm, 2 nëntor
- Kurti, Albin. Rrudhja dhe tjetërsimi,  
<http://www.vetevendosje.org/> (qasur me 21.10.2006)
- Deklaratë e Grupit të Kontaktit për statusin e ardhshëm të Kosovës, 31 janar 2006,  
<http://pristina.usmission.gov> .
- Dokumenti i decentralizimit sipas UNOSEK-ut, versioni i shtatorit 2006.
- Ekipi i Unitetit të Kosovës. 2006. Pozita e delegacionit të Kosovës për Mitrovicën.
- Express. 08 dhjetor 2006. UNMIK-u komercializon serbët.
- ICG. Statusi i Kosovës: Shtyrja është rrezik. Nr.177
- Kaloshi, Ylli. 2006. Serbët do të marrin energji nga KEK-u i tyre. Lajm, 7 dhjetor
- KIPRED dhe Hulumtimi Strategjik i Marketingut. 2006. Procesi i statusi të ardhshëm të Kosovës:  
njohuritë, qasjet dhe praktikat,  
[http://kipred.net/UserFiles/File/Kosovo\\_Future\\_Process\\_KAP\\_Survey\\_Report.pdf](http://kipred.net/UserFiles/File/Kosovo_Future_Process_KAP_Survey_Report.pdf)
- KIPRED, RTI – USAID. 2005. Perceptimet e qeverisjes lokale në Kosovë, (
- KIPRED. 2003. Review of "Reform of Local Self-Government and Public Administration in  
Kosovo: Final Recommendation" By the council of Europe Decentralisation Mission in  
Kosovo.
- Latifi, Xhevat. 2006. Gjilani kundër decentralizimit. Express, 18 nëntor.
- MPL. Urdhëresa administrative nr 2005/11 e MPL
- OSCE. 2006. Serbët e sigurojnë Ruecker-in se ata nuk do ta pranojnë pavarësinë e Kosovës,  
[http://www.osce.org/documents/mik/2003/10/698\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2003/10/698_en.pdf), (qasur me: 16 nëntor, 2006)
- UNMIK. 2000. Rregullorja e UNMIK-ut për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës 2000/45,  
[www.unmikonline.org/regulations/2000/reg45-00.htm](http://www.unmikonline.org/regulations/2000/reg45-00.htm)
- UNMIK. 06.12.2006. Transkripti i konferencës për shtyp të UNMIK-ut.
- UNMIK. 2002 “Një zgjidhje për Mitrovicën- plani me shtatë pika”, deklaratë për shtyp e UNMIK-ut,  
1 tetor (A choice for Mitrovica – the Seven Point Plan”,  
<http://www.unmikonline.org/press/pressr02.htm> (qasur me 4 nëntor 2006).
- Zëri. 2006. Ruecker-i paralajmëron më shumë kompetenca për komunat e reja me shumicë serbe. 8  
dhjetor.

Lista e peronave të intervistuar:

**Agron Dida**,– Zëvendës Ministër, Ministria e Energjisë dhe Minierave, 06.11.2006

**Ahmet Tmava**, Kryetar i degës së PDK-së, Mitrovicë, 02.11.2006

**Ahmet Tmava**, Udhëheqës i degës se PDK-së, Mitrovicë, 02.11.2006

**Albin Kurti**, Vetëvendosja, 06.11.2006

**Anton K. Berisha**, Zyrtar për rregullim në telekomunikacion, ART, 02.11.2006

**Ardian Gjini**, AAK, Ministria e Planifikimit Hapësinor, 13.11.2006

**Blerim Kuçi**, – Zëvendës Ministër, Ministria e Punëve të Brendshme, 07.11.2006

**Daut Xhemajli**, Udhëheqës i degës së PDK-së, Viti, 14.11.2006

**Emrush Xhemajli**, Kryetar i LPK-së, 15.11.2006

**Fehmi Mujota**, PDK , 06.11.2006

**Fevzi Berisha**, Zëvendës Ministër i MASHT-it, 07.11.2006

**Gjylnaze Syla**, Deputete, AAK, 31.10.2006

**Ismail Kurteshi**, Deputet në Kuvendin e Kosovë, 30.10.2006 (intervistë dhënë RTK-së)

**Jakup Krasniqi**, PDK, 13.11.2006

**Jonuz Salihaj**, Ministër i Drejtësisë, 06.11.2006

**Lutfi Haziri**, Zv. Kryeministër i Kosovës, 01.11.2006

**Mursel Ibrahim**, Kryetar i Komunës së Mitrovicës, 02.11.2006

**Musa Misini**, Kryetar i Komunës së Vitisë, 14.11.2006

**Nazim Jashari**, Deputet në Kuvendin e Kosovës, ORA, 02.11.2006

**Nazmi Selmanaj**, Kryetar i Komunës së Deçanit, 31.10.2006

**Nenad Rikalo**, Drejtor ekzekutiv, FUTURA, 30.10.2006

**Oliver Ivanoviq**, Deputet në Kuvendin e Kosovës, LSKM, 06.11.2006

**Ramë Manaj** - LDK, Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, 07.11.2006

**Ramush Tahiri**, Ish këshilltar i Kryetarit të Kuvendit, 09.11.2006